REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MIRËQENIES SOCIALE

# PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR BARAZI, PËRFSHIRJE DHE PJESËMARRJE TË ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

# (2026-2030)

**Draft**

**Mars 2026**

**SHKURTIME**

- AFP – Aftësim dhe Formim Profesional
- AKMC – Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
- AKPA – Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
- AKSHI – Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
- AMSHC – Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
- ASHK – Agjencia Shtetërore e Kadastrës
- ASHMDF – Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
- ASPA – Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
- ASCAP – Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar
- AZHBR – Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural
- BE – Bashkimi Evropian
- BK – Banka e Shqipërisë
- DAP – Departamenti i Administratës Publike
- DPAP – Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
- DRAKPA/QFPP – Drejtoria Rajonale e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive / Qendra e Formimit Profesional Publik
- DRAP/ZVAP – Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar / Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar
- FSDKSH – Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
- HIV/AIDS – Human Immunodeficiency Virus / Acquired Immune Deficiency Syndrome
- IAL – Institucion i Arsimit të Lartë
- INSTAT – Instituti i Statistikave
- ISHP – Instituti i Shëndetit Publik
- KMD – Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
- KPK – Komiteti për Pakicat Kombëtare
- KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
- MA – Ministria e Arsimit
- MBZHR – Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- MEI – Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
- MF – Ministria e Financave
- MKI – Ministria për Ekonomi dhe Inovacion
- MPB – Ministria e Punëve të Brendshme
- MPJ – Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- MSHMS – Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- MTKS – Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit
- NE – Ndihma Ekonomike
- NJMF – Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
- NJVKSH – Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor
- NJVV – Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
- OJF – Organizatë Jofitimprurëse
- OSHC – Organizata e Shoqërisë Civile

- OSHKSH – Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
- PBA – Programi i Buxhetimit Afatmesëm
- PKVBPPRE – Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve
- PNP – Programet e Nxitjes së Punësimi
- QFPP/AFP – Qendra e Formimit Profesional Publik / Aftësim dhe Formim Profesional
- QKEV – Qendra Kombëtare për Emergjencat Vendore
- QKTE – Qendra Kombëtare Transitore e Emergjencës
- REVALB – Regjistri Elektronik për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimin në Shqipëri
- ROMALB – Sistemi Kombëtar i Monitorimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve
- RSH – Republika e Shqipërisë
- RTSH – Radio Televizioni Shqiptar
- SHSSH – Shërbimi Social Shtetëror
- SKZHI – Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
- SPI – Sistemi i Planifikimi të Integruar
- SST – Sëmundje Seksulaisht e Transmetueshme
- VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave

# Tabela e Përmbajtjes

Përmbledhje Ekzekutive ....................................................................................5

Mesazhet Kryesore ....................................................................................5

PJESA I – Konteksti Strategjik ....................................................................................6

1. Hyrje dhe Qëllimi i dokumentit ....................................................................................6

1. 1 Kuadri Ligjor ....................................................................................7

1. 2 Përputhja me dokumentet strategjike ndërkombëtare ....................................................................................8

1. 3 Situata aktuale, arritjet rezultatet 2021-2025 ....................................................................................10

1. 4 Parimet Themelore ....................................................................................11

PJESA II – Qëllimet e politikës dhe objektivat specifikë ....................................................................................11

2. 1 Vizioni dhe Misioni i Dokumentit ....................................................................................11

2. 2 Qëllimet e politikës dhe objektivat strategjike për periudhën 2026-2030 ....................................................................................12

2. 3 Masat, aktivitetet dhe rezultatet e pritshme ....................................................................................18

2. 4 Mekanizmat e zbatimit, monitorimit dhe raportimit ....................................................................................32

2. 5 Përgjegjësitë institucionale ....................................................................................33

2.6 Indikatorët e performancës ....................................................................................34

2.7 Vlerësimi i impaktit ....................................................................................36

PJESA III - ANALIZA BUXHETORE ....................................................................................36

ANEKSI 2 Kuadri Ligjor Kombëtar ....................................................................................83

# Përmbledhje Ekzekutive

**Mesazhet Kryesore**

- Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2026–2030 riafirmon angazhimin e Republikës së Shqipërisë për garantimin e barazisë, promovimin e përfshirjes dhe rritjen e pjesëmarrjes efektive të romëve dhe egjiptianëve, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe objektivat e Agjendës 2030.
- Dokumenti konsolidon progresin e arritur dhe vendos një qasje të integruar, të orientuar drejt rezultateve të matshme dhe impaktit afatgjatë.
- Pesë fusha prioritare ndërsektoriale adresojnë dimensionet kryesore të përjashtimit social, duke synuar reduktimin e pabarazive strukturore dhe forcimin e aksesit në të drejta themelore.
- Plani forcon mekanizmat institucionalë të koordinimit, monitorimit dhe financimit, duke garantuar llogaridhënie dhe qëndrueshmëri në zbatim.
- Përfshirja e komuniteteve rome dhe egjiptiane trajtohet si prioritet i zhvillimit të qëndrueshëm dhe i procesit të integrimit evropian të vendit.

Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2026-2030 përfaqëson instrumentin kryesor të politikës publike të Republikës së Shqipërisë për avancimin e përfshirjes sociale dhe reduktimin e pabarazive strukturore që prekin komunitetet rome dhe egjiptiane. Dokumenti është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me institucionet e linjës, njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë.

Plani është i harmonizuar me Kornizën Strategjike të Bashkimit Evropian për Romët deri në vitin 2030 dhe kontribuon drejtpërdrejt në përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian, veçanërisht në fushat e sundimit të ligjit, të drejtave themelore dhe përfshirjes sociale. Ai është gjithashtu në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe me objektivat e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Plani synon të konsolidojë progresin e arritur gjatë ciklit të mëparshëm strategjik dhe të avancojë një qasje më të integruar dhe të orientuar drejt rezultateve në politikat e përfshirjes sociale. Ai mbështetet në parimet e barazisë, mosdiskriminimit, respektimit të të drejtave të njeriut dhe pjesëmarrjes aktive të komuniteteve rome dhe egjiptiane në proceset e politikëbërjes dhe të zbatimit të politikave publike.

Për periudhën 2026-2030, Plani përqendrohet në pesë fusha prioritare ndërsektoriale që adresojnë dimensionet kryesore të përjashtimit social. Këto përfshijnë përmirësimin e aksesit në drejtësi dhe regjistrimin civil, duke synuar eliminimin e barrierave administrative dhe financiare që kufizojnë ushtrimin e të drejtave themelore; përmirësimin e sigurisë së strehimit përmes zgjerimit të programeve të strehimit social dhe formalizimit të vendbanimeve; garantimin e aksesit më të gjerë dhe më cilësor në shërbimet shëndetësore, veçanërisht në kujdesin shëndetësor parësor dhe në ndërhyrjet parandaluese në komunitet; promovimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe reduktimin e segregimit arsimor; si dhe fuqizimin socio-ekonomik përmes rritjes së mundësive për punësim, vetëpunësim dhe sipërmarrje sociale.

Një dimension i rëndësishëm i këtij Plani është adresimi i antigjipsizmit, i njohur në nivel evropian si një formë specifike e racizmit dhe diskriminimit strukturor ndaj romëve. Në këtë kuadër, plani synon të reduktojë stereotipet dhe praktikat diskriminuese përmes forcimit të mekanizmave institucionalë të barazisë, rritjes së ndërgjegjësimit publik dhe promovimit të dialogut ndërkulturor.

Deri në vitin 2030, Plani synon të arrijë rezultate të matshme në disa fusha kyçe, duke përfshirë regjistrimin universal të lindjeve dhe reduktimin e rasteve të personave të padokumentuar, përmirësimin e sigurisë së strehimit për familjet rome dhe egjiptiane, rritjen e përdorimit të shërbimeve shëndetësore parësore dhe parandaluese, rritjen e frekuentimit dhe përfundimit të arsimit bazë dhe të mesëm, si dhe zgjerimin e

mundësive për punësim dhe vetëpunësim. Progresi në arritjen e këtyre objektivave do të matet përmes treguesve të performancës dhe mekanizmave të rregullt të monitorimit dhe raportimit.

Plani ndërton mbi përvojën e periudhës së mëparshme strategjike dhe prezanton disa risi të rëndësishme, duke përfshirë forcimin e mekanizmave të koordinimit ndërinstitucional, përdorimin e sistemeve digjitale të monitorimit dhe raportimit, si dhe integrimin më të fortë të politikave sektoriale në nivel qendror dhe vendor. Një rol më i madh i jepet gjithashtu njësive të vetëqeverisjes vendore në zbatimin e politikave të përfshirjes sociale dhe në adresimin e nevojave specifike të komuniteteve në nivel lokal.

Zbatimi i Planit mbështetet në një model të koordinuar ndërinstitucional që përfshin ministritë përgjegjëse, institucionet e pavarura, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe partnerët ndërkombëtarë, duke siguruar një qasje të integruar dhe ndërsektoriale në zbatimin e politikave. Monitorimi i progresit do të realizohet përmes mekanizmave të integruar të raportimit dhe platformave kombëtare të monitorimit.

Financimi i masave të planit do të mbështetet kryesisht në buxhetin e shtetit përmes planifikimit buxhetor afatmesëm të institucioneve përgjegjëse, ndërsa mbështetja e donatorëve dhe partnerëve ndërkombëtarë do të kontribuojë në plotësimin e nevojave financiare dhe në mbështetjen e ndërhyrjeve inovative.

Nëpërmjet këtij Plani, Qeveria e Republikës së Shqipërisë synon të përshpejtojë progresin drejt një shoqërie më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse, ku romët dhe egjiptianët gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta dhe ku përfshirja e tyre trajtohet si një komponent integral i zhvillimit të qëndrueshëm dhe i integrimit evropian të vendit.

# PJESA I – Konteksti Strategjik

## 1. Hyrje dhe Qëllimi i dokumentit

Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2026-2030 (në vijim PKVBPPRE 2026-2030) është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në emër të Qeverisë së Shqipërisë, , me mbështetjen teknike të programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Integrimi i Romëve III”. Ky program përfaqëson një ndërhyrje shumëvjeçare që synon forcimin e përfshirjes sociale dhe ekonomike të komuniteteve rome dhe egjiptiane, duke mbështetur zbatimin e politikave kombëtare për barazi dhe integrim. Ai fokusohet në përmirësimin e aksesit në arsim, punësim dhe shërbime sociale, si dhe në forcimin e kapaciteteve institucionale për monitorim, koordinim dhe zbatim më efektiv të politikave publike. Plani i përgatitur është në bashkërendim dhe konsultim të ngushtë me ministritë përgjegjëse të linjës, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, si dhe organizatat ndërkombëtare që veprojnë në fushën e barazisë, përfshirjes dhe integrimit të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri. PKVBPPRE 2026–2030 përfaqëson një angazhim strategjik afatmesëm dhe afatgjatë për periudhën 2026–2030, i orientuar drejt adresimit të pabarazive strukturore dhe forcimit të përfshirjes sociale, ekonomike dhe institucionale të pakicave Rome dhe Egjiptiane. Plani bazohet mbi përvojën dhe rezultatet e ciklit të mëparshëm strategjik, duke parashikuar përshkallëzimin e masave tashmë të zbatuara dhe atyre në proces zbatimi, si dhe zhvillimin e ndërhyrjeve të reja të orientuara drejt rezultateve.

Në përputhje me objektivat dhe parimet udhëheqëse të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2022–2030, PKVBPPRE 2026–2030 ka për qëllim të institucionalizojë një qasje të integruar dhe të qëndrueshme për përfshirjen sociale, duke kaluar nga ndërhyrje të fragmentuara drejt integrimit sistematik të përfshirjes sociale në politikat publike kombëtare dhe vendore, veçanërisht në sektorët kyç të

arsimit dhe nxitja e dialogut ndërkulturor, punësimit dhe aftësimit, kujdesit shëndetësor, strehimit, mbrojtjes sociale, akses i barabartë në drejtësi dhe në regjistrim civil dhe antigjipsizmit.

Financimi i masave të PKVBPPRE 2026–2030 do të sigurohet kryesisht nga buxheti i shtetit, përmes planifikimit buxhetor afatmesëm të ministrive përgjegjëse. Kur burimet publike të planifikuara nuk mbulojnë plotësisht nevojat financiare për zbatim, Plani i Veprimit do të identifikojë në mënyrë të strukturuar nevojat shtesë të financimit, duke krijuar bazën për mobilizimin e burimeve plotësuese, përfshirë mbështetjen e donatorëve dhe instrumenteve të tjera financiare.

Zbatimi i PKVBPPRE 2026–2030 do të monitorohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, përmes një mekanizmi të koordinuar monitorimi, me përfshirjen aktive të pikave të kontaktit në ministritë përgjegjëse të linjës dhe njësive të vetëqeverisjes vendore. Zbatimi i suksesshëm i Planit do të varet nga bashkëpunimi i ngushtë ndërinstitucional dhe ndërsektorial, si dhe nga përfshirja domethënëse e organizatave të shoqërisë civile, në përputhje me parimet e llogaridhënies, transparencës dhe monitorimit të bazuar në rezultate, të përcaktuara në kuadër të Kornizës Strategjike të BE-së për Romët 2020–2030.

## 1. 1 Kuadri Ligjor

Shqipëria ka ratifikuar instrumentet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe ka harmonizuar kuadrin e saj ligjor me standardet evropiane. Në këtë kuadër, vendi ka krijuar një bazë të avancuar ligjore dhe nënligjore për adresimin e çështjeve që lidhen me pakicat rome dhe egjiptiane, duke u mbështetur në standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Kuadri ligjor kombëtar përmban një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore që mbulojnë të gjitha aspektet e jetës së romëve dhe egjiptianëve ***(Aneksi 2: Kuadri Ligjor Kombëtar).***

Kuadri i politikave shtetërore për përfshirjen sociale në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga strategji sektoriale dhe ndërsektoriale, si dhe dokumente të tjera të politikave, siç janë:

- Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026-2028 (ankorim financiar);
- Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2024-2030 (ankorim horizontal);
- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030 (integrim ekonomik);
- Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030 ();
- Dokumenti Politik për Përfshirjen Sociale 2024-2028 (integrim sektorial me ndikim të drejtpërdrejtë)

Megjithëse kuadri ligjor kombëtar në fushat e mbrojtjes nga diskriminimi, regjistrimit civil, aksesit në drejtësi, strehimit social, shëndetësisë, arsimit, punësimit dhe mbrojtjes sociale është në përputhje të gjerë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, sfida kryesore mbetet efektiviteti i zbatimit. Në kontekstin e detyrimeve që rrjedhin nga Kapitujt 23 (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore) dhe 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria), sfidat kryesore lidhen me nevojën për përmirësim të zbatimit në nivel vendor, forcimin e koordinimit ndërinstitucional dhe konsolidimin e kapaciteteve administrative e financiare.

Në disa fusha prioritare - si legalizimi dhe siguria e strehimit për familjet në zona informale, regjistrimi i vendbanimit për personat pa dokumentacion të plotë, institucionalizimi i ndërmjetësve komunitarë, si dhe adresimi efektiv i antigjipismit - ekziston bazë ligjore dhe instrumente rregullatore, por ndikimi mbetet i kufizuar për shkak të të, mungesës së mekanizmave të fortë të zbatimit dhe monitorimit, si dhe nivelit të pamjaftueshëm të ndërgjegjësimit të përfituesve. Për këtë arsye, periudha 2026-2030 kërkon një zhvendosje

të qasjes nga konsolidimi normativ drejt forcimit të performancës institucionale, rritjes së llogaridhënies dhe ndërlidhjes së legjislacionit me instrumente konkrete buxhetore dhe tregues të matshëm rezultati.

## 1. 2 Përputhja me dokumentet strategjike ndërkombëtare

PKVBPPRE 2026-2030 përbën një instrument strategjik të ndërtuar në përputhje me angazhimet ndërkombëtare dhe kuadrin kombëtar të politikave publike. Shqipëria ka ratifikuar konventat kryesore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ka përafruar legjislacionin e saj me standardet evropiane, duke siguruar një bazë të konsoliduar normative për promovimin e barazisë dhe përfshirjes së komuniteteve rome dhe egjiptiane. Në këtë kontekst, Plani synon të operacionalizojë këtë kuadër përmes objektivave të matshme, mekanizmave të koordinimit ndërinstitucional dhe ndërlidhjes së politikave sektoriale me instrumente konkrete financiare dhe monitoruese, duke kaluar nga konsolidimi normativ drejt garantimit të ndikimit real në terren.

Dokumentet e Bashkimi Evropian, si Korniza Strategjike e BE-së për Romët 2020-2030 dhe Deklarata e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve në kuadër të Procesit të Zgjerimit, përbëjnë referencë të drejtpërdrejtë normative për hartimin e Planit të Ri të Veprimit për Romët dhe Egjiptianët. Këto dokumente lidhen ngushtë me prioritetet e përcaktuara në raportet vjetore të Komisioni Evropian për Shqipërinë, të cilat vlerësojnë progresin në fushën e të drejtave themelore, mosdiskriminimit dhe përfshirjes sociale, si pjesë e kritereve politike të anëtarësimit. Në këtë kuadër, PKVBPPRE 2026-2030 harmonizohet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030 dhe shërben si instrument konkret për përmbushjen e standardeve të acquis, duke integruar masa të matshme, indikatorë performance dhe mekanizma raportimi periodik që pasqyrohen në kuadrin e dialogut të strukturuar BE-Shqipëri dhe në raportet e zgjerimit.

Në mënyrë specifike, kontributi i planit në Kapitullin 23 (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore) lidhet me forcimin e aksesit në drejtësi, garantimin e mbrojtjes efektive kundër diskriminimit dhe rritjen e kapaciteteve institucionale për zbatimin e legjislacionit për barazi, në përputhje me standardet e BE-së dhe jurisprudencën evropiane. Plani pasqyron vullnetin e **autoriteteve shqiptare** për të fuqizuar mekanizmat mbikëqyrës të të drejtave të njeriut dhe direktivave antidiskriminim, duke synuar integrimin e plotë të pakicave rome dhe egjiptiane. Duke u bazuar në objektivat e Kapitullit 23, masa përfshijnë harmonizimin e legjislacionit kombëtar me Direktivat e BE mbi barazinë dhe parandalimin e diskriminimit, si dhe forcimin e institucioneve të pavarura të monitorimit që mbrojnë të drejtat e romëve në fusha kyçe si arsim, punësim, shëndetësi dhe banim, në përputhje me politikat dhe standardet e BE-së.

Për Kapitullin 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria), masat për regjistrimin civil, përfshirjen në sistemet arsimore dhe sociale, si dhe parandalimin e marginalizimit, kontribuojnë në reduktimin e rreziqeve që lidhen me migracionin e parregullt dhe përjashtimin social, elementë të monitoruar rregullisht në procesin e screening dhe në raportet e progresit. Kapitulli 24 mbulon një gamë çështjesh që lidhen me rendin dhe sigurinë, përfshirë migracionin, azilin, policinë, luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e kufijve, duke kërkuar një sistem të integruar që respekton të drejtat themelore. Në këtë kuadër, politika për regjistrimin civil dhe rritjen e përfshirjes në arsim dhe shërbime sociale kontribuon drejtpërdrejt në objektivat e Kapitullit 24, duke siguruar që të gjithë qytetarët, përfshirë romët, të kenë dokumentacion të rregullt dhe qasje në shërbime bazë, çka redukton rrezikun e informalitetit dhe migrimit të paautorizuar dhe përmirëson menaxhimin e migracionit në përputhje me standardet e BE-së për drejtësi dhe liri. Harmonizimi

me Direktivat e BE mbi regjistrimin civil dhe parandalimin e diskriminimit është i rëndësishëm për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve vulnerabël dhe për të përmbushur kërkesat e acquis për azil dhe megrim.

Gjithashtu, plani ka ndërlidhje me Kapitullin 19 (Politika Sociale dhe Punësimi), përmes promovimit të përfshirjes në tregun e punës dhe mbrojtjes sociale. Kapitulli19 kërkon krijimin e një kornize sociale gjithëpërfshirëse që siguron punësim të denjë, mbrojtje sociale efektive dhe përfshirje të barabartë për të gjithë, në përputhje me Strategjinë Evropiane për Punësim. Në këtë kontekst masat e planit synojnë fuqizimin e romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës. Harmonizimi me Direktivën e BE-së për Barazi në Punësim dhe standardet për mbrojtjen sociale ndihmon në uljen e pabarazive dhe diskriminimit në punësim dhe shërbime sociale, duke përmirësuar integrimin ekonomik dhe stabilitetin social të cilat janë elementë që Komisioni Evropian i monitoron rregullisht në raportet e tij vjetore të progresit.

Kapitull 28 (Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit) adreson kuadrin ligjor dhe zbatimin e standardeve të BE-së për mbrojtjen e konsumatorit dhe sigurinë e produkteve, si dhe qasjen në kujdesin shëndetësor, duke përfshirë standarde të cilat sigurojnë që shërbimet shëndetësore dhe informacioni për konsumatorët të jenë të sigurt, të qasshëm dhe të drejta. Masa të tilla si sigurimi i shërbimeve preventive, informimi i komuniteteve vulnerabël dhe lehtësimi i aksesit në shërbimet shëndetësore janë në përputhje me Direktivat e BE.

Plani kontribuon gjithashtu në Kapitullin 18 (Statistikat), përmes forcimit të sistemit të mbledhjes dhe menaxhimit të të dhënave, përfshirë sistemin elektronik ROMALB, si dhe përmes promovimit të politikëbërjes së bazuar në evidencë dhe përdorimit të platformave dixhitale të monitorimit. Në të njëjtën kohë, masat që lidhen me rritjen e ndërgjegjësimit, komunikimin publik dhe parandalimin e diskriminimit dhe antigjipsizmit kontribuojnë në Kapitullin 10 (Shoqëria e Informacionit dhe (Media), duke nxitur narrativa gjithëpërfshirëse, forcimin e besimit publik dhe kundërshtimin e stereotipeve të dëmshme.

Në tërësi, Plani mbështet integrimin horizontal të përfshirjes së romëve dhe egjiptianëve në disa kapituj të acquis, duke forcuar koherencën e politikave dhe duke kontribuar në përmbushjen e kritereve dhe benchmark-eve të BE-së në fushën e të drejtave themelore, përfshirjes sociale dhe kapaciteteve institucionale. Në këtë drejtim, ai ofron një bazë të strukturuar për të demonstruar progres të matshëm në kuadër të procesit të anëtarësimit, veçanërisht sa i përket detyrimeve të raportimit, monitorimit të performancës dhe përafrimit me kornizat strategjike të BE-së.

Progresi në këto fusha do të raportohet përmes mekanizmave kombëtarë të monitorimit, indikatorëve të përafruar me kornizën e BE-së dhe përfshirjes së tyre në raportet vjetore të zgjerimit të Komisionit Evropian, duke e bërë planin një instrument të drejtpërdrejtë të matshëm në rrugën drejt anëtarësimit.

PKVBPPRE synon të përcaktojë objektivat afatmesme të Qeverisë për arritjen e vizionit për kohezionin social të përcaktuar në SKZHI 2022–2030 II: *Mbrojtje, integrim dhe gjithëpërfshirje, nëpërmjet mënjanimit të pabarazive dhe diskriminimit për Romët dhe Egjiptianët, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët në nivel kombëtar dhe vendor, vajzat dhe gratë viktima të dhunës, trafikimit dhe shfrytëzimit*".

Nga 17 objektivat e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, PKVBPPRE 2026-2030 ndërlidhet me objektivat 1, 3, 5, 10 dhe 16, si më poshtë:

- Objektivi 1: Fund varfërisë në të gjitha format e saj dhe kudo;

- Objektivi 3: Shëndet i mirë dhe mirëqenie;
- Objektivi 5: Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave;
- Objektivi 10: Ulja e pabarazisë brenda dhe ndërmjet vendeve;
- Objektivi 16: Paqe, drejtësi dhe institucione të forta.

Nga ana tjetër, rekomandimet e Strategjisë së Këshillit të Evropës për Përfshirjen e Romëve dhe Udhëtarëve (2026–2030)[1], theksojnë fuqizimin e grave rome, pjesëmarrjen në vendimmarrje, forcimin e kapaciteteve të autoriteteve vendore dhe përdorimin e mekanizmave të monitorimit për të matur progresin. Përfshirja e këtyre elementeve në Planin 2026–2030 do t'i mundësojëndërtimin e një qasje gjithëpërfshirëse, të mbështetur në standarde ndërkombëtare dhe të fokusohet në rezultate të matshme, duke garantuar një ndikim real në jetën e pakicave rome dhe egjiptiane.

## 1. 3 Situata aktuale, arritjet rezultatet 2021-2025

Gjatë periudhës 2021–2025, zbatimi i PKVBPPRE ka shënuar arritje të rëndësishme dhe risi institucionale që kanë forcuar bazën për një qasje më të qëndrueshme ndaj barazisë dhe përfshirjes së romëve dhe egjiptianëve. Së pari, u konsolidua kuadri ligjor dhe nënligjor në disa sektorë kyç: ndryshimet në Ligjin nr. 56/2024 "Për Gjendjen Civile" dhe aktet shoqëruese krijuan lehtësime konkrete për regjistrimin civil (qartësim i vendbanimit/vendqëndrimit, verifikim në terren dhe përdorim më i gjerë i shërbimeve online), duke kontribuar në uljen graduale të rasteve të fëmijëve të paregjistruar. Njëkohësisht në drejtësi u shënua një zgjerim i prekshëm i aksesit në programin e Ndihmës Juridike Falas, me rritje të përfituesve nga komuniteti romë dhe egjiptianë, forcim të rrjetit të ofruesve (qendra shërbimi, klinika ligjore universitare, OJF të autorizuara dhe kontraktim i avokatëve), si dhe intensifikim të aktiviteteve informuese.

Në shëndetësi, reforma ligjore dhe instrumentet praktike prodhuan rezultate të matshme: u rrit ndjeshëm numri i grave rome dhe egjiptiane që përfituan barna falas dhe ekzaminime gjatë shtatzënisë (nga 1,273 përfitues në vitin 2021 në 3,833 në vitin 2024), u forcua kapaciteti i personelit përmes trajnimeve, ndërsa ekipet mjekësore lëvizëse u konsoliduan si një risi funksionale për kapërcimin e barrierave territoriale, duke asistuar në mënyrë të qëndrueshme dhjetëra mijëra persona çdo vit; gjithashtu, programi "Bonusi i Bebes" shënoi rritje thelbësore të përfituesve..

Në strehimin social, u zgjeruan programet dhe instrumentet e strehimit social (sidomos subvencioni i qirasë, me rritje të vazhdueshme të numrit të familjeve përfituese), u përmirësua planifikimi vendor me rritje të numrit të bashkive me plane 5-vjeçare për strehimin dhe u hodhën hapa të rëndësishëm për përshpejtimin e procedurave të legalizimit përmes marrëveshjeve ndërinstitucionale, hapjes së zyrave të posaçme dhe asistencës direkte për familjet (me mbështetje edhe nga programi Roma Integration III).

Në arsim, risi të rëndësishme ishin garantimi i teksteve falas, rritja e mbështetjes për transport falas, zgjerimi i programeve jashtë-kurrikulare dhe rritja e numrit te bursave, ndërsa mekanizmat e referimit "arsim dhe mbrojtje sociale" u forcuan, megjithëse treguesit e regjistrimit shfaqën rënie graduale për shkak të lëvizshmërisë dhe faktorëve demografikë.

Në punësim dhe aftësim, u zgjerua shtrirja e shërbimeve të këshillimit dhe programeve aktive, si dhe filloi zbatimi i Garancisë Rinore si një kornizë e re për kalimin e të rinjve drejt ofertave të punësimit/arsimit/trajnimit.

---

[1] Këshilli i Evropës. (2025). Koncepti i Takimit të 19-të të Dialogut të Këshillit të Evropës me shoqërinë civile të romëve dhe udhëtarëve. https://rm.coe.int/concept-note-of-the-19th-dialogue-meeting-of-the-council-of-europe-dia/1680b415cc

Në mbrojtjen sociale, u zgjerua ofrimi i shërbimeve sociale përmes Fondit Social dhe u rrit përdorimi i disa masave lehtësuese (p.sh. "klient në nevojë" për energjinë), edhe pse skema e ndihmës ekonomike, evidentoi nevojën për forcim të masave për riintegrim aktiv social-ekonomik të përfituesve.Bashkërendimi për masat nga grupet ndërdisiplinore nga hallkat vendore të referimit janë monitoruar përmes ROMALB[2] në sistem qendror dhe vendor në gjithë bashkitë e vendit. Njëkohësisht referimi është kryer nga REVALB dhe funksionalizimi i MKR (Mekanizmi Kombetar i Referimit te Rasteve të Dhunës në Familje) në 61 bashki. Në tërësi, risia më e madhe ndërsektoriale e kësaj periudhe ishte ndërtimi i një arkitekture më moderne monitorimi dhe ndërveprimi institucional për realizimin e Planit Kombëtar të Veprimit nga gjithë institucionet, progresi i të cilëve është regjistruar përmes ROMALB, duke përditësuar indikatorët. Për sa i përket digjitalizimit të shërbimeve dhe mekanizmave të referimit, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimi do të përbëjnë themelin për Planin e ri të Veprimit për komunitetet rome dhe egjiptiane për periudhën 2026–2030, edhe pse sfidat në kapacitete dhe koordinim ndërinstitucional vijojnë të ndikojnë cilësinë e raportimit dhe qëndrueshmërinë e rezultateve.

### 1. 4 Parimet Themelore

Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2026–2030 udhëhiqet nga parime që synojnë përfshirjen e plotë të këtyre komuniteteve në shoqëri. Plani aplikon një qasje të targetuar për adresimin e nevojave specifike dhe situatave emergjente, promovon dialogun dhe ndërveprimin ndërkulturor, respekton dallimet brenda dhe ndërmjet komuniteteve, duke integruar në mënyrë të qartë dimensionin gjinor. Zbatimi i tij mbështetet në bashkëpunimin ndërinstitucional në nivel qendror dhe vendor, përfshirjen e shoqërisë civile, donatorëve, organizatave ndërkombëtare dhe përdorimin e instrumenteve ligjore, financiare dhe koordinuese të Bashkimit Evropian. Plani parashikon tregues për monitorimin e progresit dhe buxhetim të dedikuar nga ministritë e linjës, duke identifikuar hendekët e financimit për mobilizimin e burimeve plotësuese, përfshirë mbështetjen e donatorëve.

## PJESA II – Qëllimet e politikës dhe objektivat specifikë

### 2. 1 Vizioni dhe Misioni i Dokumentit

**VIZIONI:** Një shoqëri shqiptare dinamike dhe gjithëpërfshirëse, ku komunitetet rome dhe egjiptiane gëzojnë barazi të vërtetë dhe akses të papenguar në arsim cilësor në të gjitha nivelet, i cili i pajis me aftësi dhe kompetenca thelbësore; mundësi të qëndrueshme punësimi, paga të drejta dhe karriera dinjitoze; strehim të sigurt që forcon ndjenjën e përkatësisë; kujdes shëndetësor gjithëpërfshirës që adreson çdo aspekt të mirëqenies; si dhe shërbime sociale thelbësore që mbështesin nevojat e tyre. Përmirësimi i ndjeshëm i cilësisë së jetës së tyre përmes ofrimit të burimeve dhe mundësive reale, duke punuar aktivisht për ngushtimin e hendekut social dhe ekonomik ndërmjet këtyre komuniteteve dhe pjesës tjetër të shoqërisë, si dhe duke promovuar mirëkuptim, vlerësim dhe respekt kulturor.

---

[2] ROMALB është sistemi elektronik kombëtar i monitorimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Romët dhe Egjiptianët, i administruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Ai shërben për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi zbatimin e masave në nivel qendror dhe vendor, duke mundësuar raportim periodik, ndjekje të treguesve të performancës dhe rritje të transparencës dhe llogaridhënies institucionale. Përmes ROMALB sigurohet një qasje më e strukturuar dhe e harmonizuar me kërkesat e monitorimit në kuadër të integrimit evropian.

**MISIONI:** Promovimi i barazisë dhe fuqizimi i komuniteteve rome dhe egjiptiane përmes politikave të qëndrueshme, të bazuara në të drejtat e njeriut, në përputhje me standardet më të larta të Bashkimit Evropian dhe referencat e tjera ndërkombëtare. Nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me pushtetin vendor, organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e komuniteteve, synojmë të krijojmë një mjedis ku çdo individ ka mundësinë të zhvillohet dhe të kontribuojë, duke ndërtuar një të ardhme më të drejtë dhe më gjithëpërfshirëse për të gjithë.

## 2. 2 Qëllimet e politikës dhe objektivat strategjike për periudhën 2026-2030

**<u>Qëllimi i politikës I: Akses i barabartë në drejtësi dhe në regjistrim civil</u>**

*"Sigurimi i barazisë reale dhe efektive në sistemin e drejtësisë dhe shërbimet civile, përmes eliminimit të barrierave ligjore, administrative dhe financiare për pakicat rome dhe egjiptiane".*

Regjistrimi civil mbetet një parakusht thelbësor për ushtrimin e të drejtave themelore dhe aksesin në shërbime sociale, shëndetësore, arsimore dhe strehim, ndërkohë që pengesat strukturore vijojnë të prekin një pjesë të romëve dhe egjiptianëve. Zbatimi efektiv i këtij qëllimi kontribuon drejtpërdrejt në përfshirjen e plotë ligjore dhe shoqërore të pakicave rome dhe egjiptiane, në përputhje me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit.




Figura 1: Qëllimi i politikës I. Objektivat specifikë

Në fushën e aksesit të barabartë në drejtësi dhe në regjistrim civil synohet garantimi dhe mbrojtja ligjore efektive e romëve dhe egjiptianëve. Ato synojnë forcimin e aksesit në shërbimet e gjendjes civile dhe në shërbimet e Ndihmës Juridike Falas (parësore dhe dytësore). Ndërhyrjet adresojnë pengesat ligjore, administrative dhe praktike që lidhen me regjistrimin e lindjeve, transferimin e vendbanimit dhe pasaktësitë në dokumentacion. Theksi vihet në eliminimin e rasteve të mosregjistrimit dhe regjistrimit të paplotë, veçanërisht për familjet që jetojnë në kushte informale ose në lëvizje. Njëkohësisht, synohet thjeshtimi i procedurave dhe shtrirja territoriale e ndihmës juridike si instrument kyç për ushtrimin e të drejtave themelore.

**<u>Qëllimi i politikës II: Strehimi</u>**

*"Sigurimi i strehimit dinjitoz dhe i qëndrueshëm për komunitetet rome dhe egjiptiane përmes formalizimit të vendbanimeve dhe integrimit në programet e strehimit social".*

Qëllimi strategjik për strehimin është konsolidimi i mekanizmave ligjorë dhe vendorë për të përshpejtuar proceset e legalizimit dhe për të zgjeruar skemat e strehimit social për familjet rome dhe egjiptiane. Ai synon kalimin nga zgjidhjet afatshkurtra drejt formave të qëndrueshme, përmes rritjes së kapaciteteve të strukturave përgjegjëse dhe konsolidimit të praktikave të mira të zbatuara në vitet e fundit. Zbatimi i këtij qëllimi synon rritjen e sigurisë së strehimit, forcimin e të drejtave pronësore dhe garantimin e aksesit të barabartë të romëve dhe egjiptianëve në politikat e strehimit social dhe zhvillimit urban.




Figura 2: Qëllimi i politikës II. Objektivat specifikë

Objektivi për fushën e strehimit fokusohet në adresimin e pengesave ligjore, administrative dhe socio-ekonomike që kufizojnë sigurinë e strehimit dhe përfitimin nga programet publike, veçanërisht për familjet që jetojnë në vendbanime jo-formale ose në kushte pasigurie strehimi. Zbatimi i këtij objektivi synon rritjen e sigurisë së strehimit, forcimin e të drejtave pronësore dhe garantimin e zgjidhjeve të qëndrueshme dhe të integruara të strehimit për familjet rome dhe egjiptiane, në përputhje me parimet e barazisë dhe përfshirjes sociale.

**<u>Qëllimi i politikës III: Kujdesi Shëndetësor</u>**

*"Garantimi i mbrojtjes së shëndetit dhe aksesit universal në shërbime shëndetësore cilësore për pakicat rome dhe egjiptiane, duke eliminuar pabarazitë në treguesit e jetëgjatësisë dhe mirëqenies".*

Anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane në Shqipëri vazhdojnë të përballen me pengesa të konsiderueshme në aksesin në shërbimet shëndetësore, të ndërlidhura me pasigurinë ekonomike, përjashtimin nga skemat formale dhe pabarazitë strukturore në sistemin e kujdesit shëndetësor. Qëllimi i politikës për kujdesin shëndetësor është të garantojë e mbrojtjes së shëndetit dhe aksesit universal në shërbime shëndetësore cilësore për romët dhe egjiptianët. Zbatimi i këtij qëllimi kontribuon në përmirësimin e rezultateve shëndetësore, uljen e pabarazive sociale në shëndet dhe forcimin e përfshirjes së qëndrueshme të këtyre komuniteteve në sistemin shëndetësor publik.




Figura 3: Qëllimi i politikës III. Objektivat specifikë

Objektivat për fushën e shëndetësisë, së pari, kanë për synim sigurimin e aksesit të barabartë të romëve dhe egjiptianëve në shërbimet shëndetësore parësore dhe parandaluese, përmes afrimit të shërbimeve pranë qytetarit dhe eliminimit të barrierave gjeografike, financiare dhe institucionale që kufizojnë përdorimin e tyre. Së dyti, përqendrohet në krijimin, institucionalizimin dhe funksionalizimin e qëndrueshëm të sistemit të mediatorëve shëndetësorë nga këto komunitete, si mekanizëm ndërmjetësues për të ndërtuar besim midis komuniteteve dhe sistemit të kujdesit shëndetësor, për të përmirësuar komunikimin dhe për të ofruar udhëzime efektive për shërbimet. Paralelisht, objektivat synojnë fuqizimin e informimit, edukimit dhe promocionit shëndetësor të romëve dhe egjiptianëve, me fokus të veçantë në shëndetin riprodhues, amësinë dhe parandalimin e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, duke rritur ndërgjegjësimin dhe përdorimin e shërbimeve parandaluese.

**<u>Qëllimi i politikës IV: Arsimi dhe Nxitja e Dialogut Ndërkulturor</u>**

*"Forcimi i barazisë së mundësive në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për romët dhe egjiptianët, nga arsimi parashkollor deri në arsimin e lartë, si dhe promovimi i dialogut ndërkulturor për romët dhe egjiptianët."*

Ky qëllim synon garantimin e aksesit të barabartë, me cilësi të lartë dhe gjithëpërfshirës në arsim për romët dhe egjiptianët në të gjitha nivelet, nga arsimi parashkollor deri në arsimin e lartë, duke adresuar në mënyrë të strukturuar pabarazitë që shfaqen herët dhe thellohen gjatë gjithë ciklit shkollor. Pavarësisht progresit në regjistrim dhe masave mbështetëse si tekstet falas, bursat dhe transporti, pjesëmarrja dhe përfundimi i arsimit, mbeten të paqëndrueshme dhe janë të ndjeshme ndaj faktorëve si migrimi, varfëria dhe braktisja e hershme. Qëllimi fokusohet në forcimin e masave parandaluese dhe ndërhyrëse për mbajtjen dhe rikthimin në shkollë, përmirësimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe forcimin e koordinimit ndërsektorial midis arsimit, mbrojtjes sociale dhe shërbimeve komunitare, për të zvogëluar hendekun rsimor dhe për të siguruar përfshirjen e qëndrueshme të romëve dhe egjiptianëve në sistemin arsimor.




Figura 4: Qëllimi i politikës IV. Objektivat specifikë

Objektivat për fushën Arsimi dhe Nxitja e Dialogut Ndërkulturor përfshin, së pari, sigurimin e një sistemi arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për romët dhe egjiptianët në të gjitha nivelet e arsimit, duke garantuar aksesin, pjesëmarrjen e qëndrueshme dhe përfundimin e arsimit përmes masave mbështetëse financiare, sociale dhe institucionale; së dyti, promovimin e një mjedisi arsimor të orientuar drejt cilësisë dhe gjithëpërfshirjes, që parandalon segregimin, paragjykimet, diskriminimin dhe praktikat përjashtuese në institucionet arsimore, duke mundësuar pjesëmarrjen e plotë të romëve dhe egjiptianëve në të gjithë ciklin arsimor. Së treti, integrimin e trashëgimisë kulturore rome dhe egjiptiane në identitetin dhe mozaikun e trashëgimisë kulturore shqiptare, përmes rritjes së programeve dhe aktiviteteve publike kulturore, forcimit të përfaqësimit në institucionet publike të kulturës, si dhe dokumentimit dhe digjitalizimit të trashëgimisë kulturore materiale dhe jo-materiale, me qëllim forcimin e identitetit kulturor, rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe promovimin e diversitetit kulturor.

**<u>Qëllimi i politikës V: Punësimi dhe Aftësimi</u>**

*"Garantimi i aksesit të barabartë në tregun e punës dhe fuqizimi ekonomik i pakicave rome dhe egjiptiane përmes punësimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës."*

Pavarësisht ekzistencës së programeve aktive të nxitjes së punësimit dhe shërbimeve të këshillimit, hendeku në arsim dhe aftësi profesionale vazhdon të kufizojë përfshirjen e plotë në punësimin formal. Ky qëllim i PKV ka në fokus forcimin e lidhjes ndërmjet formimit profesional, zhvillimit të aftësive dhe punësimit, zgjerimin e aksesit në programet publike të punësimit përmes ndërmjetësimit komunitar dhe mbështetjes praktike. Zbatimi i tij synon rritjen progresive të punësimit formal dhe të qëndrueshëm të romëve dhe egjiptianëve, në përputhje me angazhimet e Deklaratës së Poznanit dhe objektivat e integrimit evropian.




Figura 5: Qëllimi i politikës V. Objektivat specifikë

Plani përfshin masa të rëndësishme mbi trajnimin, aktivizimin dhe pjesëmarrjen në programet e punësimit; megjithatë, masat nga ana e kërkesës duken më pak të zhvilluara. Në veçanti, theksi është i kufizuar në stimujt për punëdhënësit, zbatimin e ligjit kundër diskriminimit në punësim dhe mbështetjen për mbajtjen e vendeve të punës (p.sh. mentorim, transport, kujdes për fëmijët). Forcimi i këtyre komponentëve do të përmirësonte qëndrueshmërinë e rezultateve të punësimit.
Objektivat për fushën e punësimit dhe formimit synojnë punësimin e qëndrueshëm dhe formal të romëve dhe egjiptianëve, duke adresuar pengesat që lidhen me aftësitë, mungesën e informacionit dhe aksesin e kufizuar në shërbimet publike të punësimit. Paralelisht, promovohet fuqizimi ekonomik përmes mbështetjes së vetëpunësimit, sipërmarrjes sociale dhe integrimit të romëve dhe egjiptianëve në sektorët e ekonomisë së gjelbër. Në të njëjtën kohë, objektivi i fundit fokusohet në përmirësimin e kapaciteteve institucionale dhe cilësisë së shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional, të garantojë nëpërmjet forcimit të kompetencave të stafit, shërbimeve të personalizuara dhe koordinimit ndërinstitucional akses të barabartë dhe integrim të qëndrueshëm të romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës.

**<u>Qëllimi i politikës VI: Mbrojtja Sociale</u>**

*“Garantimi i një sistemi të mbrojtjes sociale gjithëpërfshirëse që siguron mirëqenien, riintegrimin socio-ekonomik dhe mbrojtjen e pakicave rome dhe egjiptiane, duke forcuar rolin parandalues, integrimin me shërbimet vendore dhe tranzicionin nga mbështetja pasive drejt aktivizimit social dhe ekonomik, me fokus të veçantë tek grupet më vulnerabël dhe reagimin ndaj krizave, duke forcuar rolin parandalues, integrimin me shërbimet vendore dhe tranzicionin nga mbështetja pasive drejt aktivizimit social dhe ekonomik”.*

Ky qëllim synon garantimin e një sistemi mbrojtjeje sociale gjithëpërfshirës që siguron mirëqenien, riintegrimin socio-ekonomik dhe mbrojtjen e romëve dhe egjiptianëve, me fokus të veçantë tek grupet më vulnerabël dhe aftësinë e sistemit për të reaguar ndaj situatave të krizës. Pavarësisht përmirësimeve në kuadrin ligjor dhe digjitalizimit të skemave të asistencës sociale, barrierat praktike – si mungesa e dokumentacionit, vështirësitë në përditësimin e adresës së vendbanimit dhe kapacitetet e pabarabarta në nivel vendor – vijojnë të kufizojnë aksesin efektiv në skema dhe shërbime.

Në këtë kuadër, ndërhyrjet fokusohen në forcimin e mekanizmave të identifikimit, vlerësimit, referimit dhe menaxhimit të rasteve, si dhe në ndërlidhjen funksionale të skemave të mbrojtjes sociale me shërbimet sociale, arsimin, formimin profesional dhe programet aktive të punësimit. Zbatimi i këtyre masave synon reduktimin e varësisë afatgjatë nga ndihma monetare, forcimin e autonomisë ekonomike dhe garantimin e mbrojtjes sociale në përputhje me parimet e barazisë, mosdiskriminimit dhe kohezionit social.

Në fushën e mbrojtjes sociale, objektivat deri në vitin 2030 synojnë fuqizimin e sistemit për romët dhe egjiptianët përmes zgjerimit të mbulimit me shërbime dhe zhvillimit të shërbimeve të integruara komunitare, duke rritur njëkohësisht qëndrueshmërinë e sistemit ndaj krizave. Qasja e re bazohet në tranzicionin gradual nga mbështetja financiare pasive drejt modelit të aktivizimit dhe riintegrimit socio-ekonomik, përmes koordinimit të skemave të ndihmës ekonomike me shërbimet sociale, formimin profesional dhe programet aktive të punësimit.




Figura 6: Qëllimi i politikës VI. Objektivat specifikë

Në fushën e mbrojtjes sociale, objektivat synojnë fuqizimin e sistemit për romët dhe egjiptianët, duke siguruar **zgjerimin e mbulimit me shërbime**, zhvillimin e shërbimeve të integruara komunitare dhe rritjen e qëndrueshmërisë ndaj krizave deri në vitin 2030, përmes kalimit nga mbështetja financiare pasive drejt modelit të riintegrimit socio-ekonomik. Paralelisht, objektivi i dytë, synon forcimin e rolit të sistemit të mbrojtjes sociale në identifikimin, referimin dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit dhe shfrytëzimit, përmes një qasjeje të integruar të menaxhimit të rasteve dhe ofrimit të shërbimeve sociale gjithëpërfshirëse. Ai fokusohet në forcimin e kapaciteteve të strukturave vendore dhe qendrore për të garantuar ndërhyrje të hershme, vlerësim të individualizuar të nevojave dhe mbështetje afatgjatë për viktimat dhe personat në rrezik.

**<u>Qëllimi i politikës VI: Antigjipsizmi</u>**

*"Garantimi i barazisë gjithëpërfshirëse dhe mbrojtjes nga diskriminimi për pakicat rome dhe egjiptiane, përmes forcimit të mekanizmave ligjorë, reformave institucionale dhe promovimit të një kulture shoqërore gjithëpërfshirëse".*

Politika VI fokusohet në forcimin e mekanizmave ligjorë, zbatimin e reformave institucionale dhe promovimin e një kulture shoqërore gjithëpërfshirëse, për të parandaluar dhe adresuar diskriminimin përtej trajtimit rast pas rasti. Zbatimi i këtij qëllimi synon shndërrimin e angazhimeve politike në standarde të detyrueshme, mekanizma funksionalë dhe llogaridhënie efektive, në funksion të ndërtimit të një shoqërie të barabartë dhe pa diskriminim.




Figura 6: Qëllimi i politikës VI. Objektivat specifikë

Objektivat specifike synojnë integrimin e konceptit të antigjipsizmit në kuadrin ligjor, strategjik dhe në praktikat e përditshme të administratës publike, me qëllim adresimin e tij si formë e diskriminimit strukturor. Në të njëjtën kohë, ato fokusohen në rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi të drejtat, historinë dhe kontributin e romëve dhe egjiptianëve në shoqërinë shqiptare, duke synuar parandalimin e stereotipave, gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të motivuara nga paragjykimi. Paralelisht, objektivat synojnë garantimin e mbrojtjes ligjore të barabartë dhe rritjen e pjesëmarrjes efektive të romëve dhe egjiptianëve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal dhe kombëtar, përmes forcimit të aksesit në drejtësi, fuqizimit të organizatave të komunitetit si aktorë të avokimit, monitorimit dhe llogaridhënies, si dhe ndërtimit të një reagimi të koordinuar ndërinstitucional që e kthen luftën kundër antigjipsizmit në politika të zbatueshme, të matshme dhe me ndikim të qëndrueshëm deri në vitin 2030.

## 2. 3 Masat, aktivitetet dhe rezultatet e pritshme

### Fusha: Akses i barabartë në drejtësi dhe në regjistrim civil

Objektivi I.1 që lidhet me *garantimin e integritetit civil të romëve dhe egjiptianëve përmes eliminimit të rasteve të paregjistruara dhe rregullimit të statusit të vendbanimit*, si parakusht për ushtrimin e të drejtave themelore dhe aksesin e barabartë në shërbimet publike.

Në përmbushje të këtij objektivi politik, do të synohet arritja e regjistrimit universal të çdo lindjeje dhe përditësimi i adresave të vendbanimit për të gjitha familjet rome dhe egjiptiane, përmes përmirësimit të mekanizmave ligjorë dhe administrativë në nivel qendror dhe vendor. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet familjeve që jetojnë në zona informale, familjeve në lëvizje dhe rasteve të lindjeve brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim eliminimin e barrierave financiare, procedurale dhe territoriale për regjistrimin civil.

Objektivi specifik 1.1 parashikon masat prioritare të mëposhtme:

- Identifikimi aktiv në terren i personave të paregjistruar dhe asistimi i tyre në të gjitha procedurat e dokumentimit civil, përfshirë rastet e lindjeve jashtë vendit;
- Sigurimi i shërbimeve falas për legalizimin, përkthimin dhe verifikimin e dokumenteve të nevojshme për regjistrim civil;
- Zbatimi i mekanizmave që mundësojnë regjistrimin e vendbanimit përmes vërtetimeve faktike për familjet që banojnë në zona informale ose pa titull pronësie;
- Thjeshtimi i procedurave administrative për transferimin e dosjes civile në bashkinë ku familja jeton aktualisht;
- Rritja e kapaciteteve dhe trajnimi i punonjësve të gjendjes civile mbi procedurat e thjeshtuara, përdorimin e shërbimeve elektronike dhe ndjeshmërinë kulturore;
- Zhvillimi i fushatave informuese dhe ndërgjegjësuese mbi rëndësinë e regjistrimit në kohë të lindjeve dhe përdorimin e procedurave të reja digjitale përmes e-Albania.

Rezultatet e pritshme deri në 2030 janë:

Të arrihet regjistrimi universal i çdo lindjeje dhe përditësimi i adresave të vendbanimit për të gjitha familjet rome dhe egjiptiane, duke siguruar akses të plotë në shërbimet publike.

Indikatorë të matshëm:

1. Numri i nëpunësve të gjendjes civile të trajnuar për trajtimin pa diskriminim të rasteve specifike të komunitetit.
2. Numri i testeve të ADN-së dhe procedurave të legalizimit të dokumenteve të financuara nga shteti.

Objektivi i dyte (I.2) synon *garantimin e mbrojtjes ligjore falas dhe efektive për romët dhe egjiptianët, përmes forcimit të kuadrit ligjor dhe institucional dhe shtrirjes së shërbimeve të ndihmës juridike në nivel vendor*. Në përmbushje të këtij qëllimi politik, gjatë periudhës 2026-2030 do të vijojë përmirësimi dhe thjeshtimi i kuadrit ligjor për ndihmën juridike falas, në mënyrë që të adresohen barrierat financiare, administrative dhe procedurale që kufizojnë përfitimin nga këto shërbime për romët dhe egjiptianët. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet forcimit të kapaciteteve institucionale në nivel qendror dhe vendor, si dhe garantimit të aksesit të barabartë territorial në shërbimet e ndihmës juridike parësore dhe dytësore.

Sipas objektivit specifik I.2, palët e interesit kanë përcaktuar masat prioritare si më poshtë:

- Ofrimi i asistencës juridike përmes klinikave ligjore dhe zyrave vendore të dedikuara;

- Krijimi i rrjetit të avokatëve të gatshëm për përfaqësim gjyqësor (ndihmë dytësore) për këto komunitete;
- Amendimi i ligjit për ndihmën juridike për të lehtësuar kriteret e përfitimit për romët dhe egjiptianët;
- Realizimi i fushatave informuese mbi të drejtat ligjore dhe procedurat e aplikimit për ndihmë falas;
- Ofrimi i sesioneve specifike për gratë dhe vajzat mbi të drejtat e tyre pronësore dhe trashëgiminë.

Rezultatet e pritshme deri në 2030 janë:

- Qytetarët romë dhe egjiptianë përfitojnë mbrojtje juridike efektive (parësore dhe dytësore) pa asnjë barrierë financiare apo administrative.

Indikatorë të matshëm:

1. Numri i personave romë dhe egjiptianë që kanë përfituar asistencë juridike (parësore dhe dytësore).
2. Numri i zyrave të reja të ndihmës juridike të hapura në bashkitë me përqendrim të lartë të komuniteteve.

## Fusha: Strehimi

Objektivi II.1 synon *konsolidimin e mekanizmave ligjorë dhe vendorë për përshpejtimin e proceseve të legalizimit dhe zgjerimin e skemave të strehimit social për familjet rome dhe egjiptiane*, si element kyç për garantimin e sigurisë së strehimit dhe parandalimin e pasigurisë së pronësisë. Ky objektiv është thelbësor për eliminimin e formave të strehimit të pasigurt dhe për sigurimin e një qasjeje të barabartë dhe të qëndrueshme në politikat e strehimit social dhe zhvillimit urban në nivel vendor. Deri në vitin 2030, do të synohet forcimi i kapaciteteve operative, administrative dhe buxhetore të njësive të vetëqeverisjes vendore, në mënyrë që ato të jenë në gjendje të adresojnë në mënyrë efektive nevojat për strehim të komuniteteve rome dhe egjiptiane. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet zonave me përqendrim të lartë të komuniteteve, familjeve që jetojnë në banesa informale dhe rasteve kur legalizimi nuk është i mundur për shkak të planeve urbanistike, duke garantuar zgjidhje alternative të qëndrueshme dhe pa zhvendosje të detyruara.

Në kuadër të objektivit specifik II. 1, janë planifikuar masat prioritare të mëposhtme:

- Përshpejtimi i procedurave të legalizimit për banesat në zonat me përqendrim të komuniteteve rome dhe egjiptiane;
- Miratimi dhe zbatimi i rregulloreve që parashikojnë trajtim prioritar me strehim social për familjet, banesat e të cilave nuk mund të legalizohen për shkak të planeve urbanistike;
- Ofrimi i asistencës teknike për njësitë e vetëqeverisjes vendore në hartimin e planeve afatmesme dhe afatgjata të strehimit dhe në aplikimin për fonde pranë ministrisë përgjegjëse;
- Rritja e kapaciteteve të stafit vendor përmes trajnimeve mbi kriteret e pikëzimit dhe mekanizmat që favorizojnë grupet e margjinalizuara në programet e strehimit social;
- Krijimi i mekanizmave mbështetës financiar, përfshirë grante dhe bonuse qiraje, për mbulimin e kostove të strehimit për familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme;

- Ndërlidhja e programeve të strehimit social me programet e punësimit dhe mbrojtjes sociale, për të garantuar qëndrueshmërin afatgjatë të pagesave të qirasë ose kredive;
- Përditësimi i bazës së të dhënave mbi nevojat reale për strehim në nivel lagje dhe bashkie, përmes censusit të strehimit;
- Zhvillimi i fushatave informuese"derë më derë"mbi mundësitë e aplikimit për programet e strehimit social dhe procedurat e legalizimit.

Rezultatet e pritshme deri në 2030 janë:

Të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) të kenë kapacitete të plota operative dhe buxhetore për të adresuar nevojat për strehim të komuniteteve, duke eliminuar rastet e mungesës së strehimit dhe pasigurisë së pronësisë.

Indikatorë të matshëm:

1. Numri i familjeve që përfitojnë subvencionim të plotë të qirasë (bonus strehimi) ose kredi të buta.
2. Numri i objekteve në posedim të familjeve rome/egjiptiane të legalizuara ose të trajtuara me masa alternative (kompensim/strehim).
3. Përqindja e NJVV-ve që kanë plane 5-vjeçare strehimi aktive dhe të financuara nga Buxheti i Shtetit.

## Fusha: Kujdesi Shëndetësor

Masat kryesore për arritjen e objektivave në fushën e kujdesit shëndetësor synojnë përmirësimin e gjendjes shëndetësore të romëve dhe egjiptianëve përmes garantimit të aksesit të barabartë, cilësor dhe të qëndrueshëm në shërbimet shëndetësore parësore, parandaluese dhe kurative.

Objektivi III. "*Sigurimi i shërbimeve shëndetësore parësore dhe parandaluese përmes afrimit të shërbimit te qytetari dhe eliminimit të barrierave gjeografike e financiare"*është thelbësor për reduktimin e pabarazive shëndetësore dhe përmirësimin e treguesve të shëndetit, jetëgjatësisë dhe mirëqenies në komunitetet rome dhe egjiptiane.
Në kuadër të objektivit specifik III.1, janë planifikuar masat prioritare si më poshtë:

- Forcimi dhe institucionalizimi i shërbimeve të ekipeve mobile shëndetësore, duke garantuar mbulim territorial sistematik, frekuencë të rregullt vizitash dhe mekanizëm efektiv referimi me afat maksimal 14 ditë për rastet e identifikuara.
- Rritja e mbulimit të kontrollit bazë mjekësor për grupmoshën 35–70 vjeç, përmes mekanizmave aktivë të identifikimit dhe ndjekjes sistematike sipas gjinisë dhe grupmoshave.
- Organizimi i vizitave periodike të vaksinimit në terren dhe zbatimi i sistemit aktiv të gjurmimit dhe rikujtimit për fëmijët me vaksina të vonuara, për të garantuar përfundimin në kohë të kalendarit kombëtar të vaksinimit dhe eliminimin e rasteve me fruth dhe rubeolë.
- Zhvillimi dhe zbatimi i një programi të detyrueshëm trajnimi për mosdiskriminim dhe integrimi i protokolleve anti-diskriminim në manualet e cilësisë së QSH-ve, si dhe vendosja e mekanizmit të raportimit dhe monitorimit të rasteve të diskriminimit.
- Vendosja e mekanizmit të ndjekjes aktive për gratë shtatzëna rome dhe egjiptiane, për garantimin e realizimit të 4 vizitave antenatale dhe përfitimin e paketës së plotë antenatal/postnatal.

- Miratimi i protokollit të detyrueshëm të referimit nga materniteti drejt Qendrës Shëndetësore, për realizimin e vizitës neonatale brenda 7 ditëve nga lindja.
- Rishikimi i kuadrit ligjor për regjistrimin pranë mjekut të familjes, me qëllim eliminimin e barrierave administrative për personat pa dokumente identifikimi.
- Forcimi i mekanizmave të informimit dhe asistencës për përfitimin e bonusit të bebes, në bashkëpunim me strukturat sociale dhe mediatorët komunitarë.
- Zhvillimi i fushatave të targetuara ndërgjegjësuese dhe edukative, për aksesimin e shërbimeve shëndetësore, sistemin e referimit dhe përdorimin e platformës e-Albania, me mbështetjen e mediatorëve.

Rezultatet e pritshme deri në 2030:

Rritje e ndjeshme e mbulimit dhe përdorimit të shërbimeve shëndetësore bazë dhe parandaluese nga komunitetet rome dhe egjiptiane, me reduktim të dukshëm të pabarazive në aksesin në shërbime shëndetësore.

Indikatorë të matshëm:

1. % e rasteve të referuara nga ekipet mobile që marrin shërbim brenda 14 ditëve.
2. Numri i vizitave të kryera nga ekipet mobile për 1,000 banorë romë/egjiptianë.
3. % e personave 35-70 vjeç që kryejnë kontrollin mjekësor bazë sipas grupmoshave dhe gjinisë.

Objektivi III. 2 synon *krijimin, institucionalizimin dhe funksionalizimin e qëndrueshëm të sistemit të mediatorëve shëndetësorë nga komunitetet rome dhe egjiptiane, si mekanizëm kyç për ndërtimin e besimit mes komuniteteve dhe sistemit shëndetësor.* Ky objektiv është thelbësor për përmirësimin e komunikimit, orientimit dhe përdorimit efektiv të shërbimeve shëndetësore, si dhe për rritjen e përfaqësimit të romëve dhe egjiptianëve në sistemin publik shëndetësor.

Masat prioritare për objektivin specifik III.2, janë si më poshtë:

- Zgjerimi i rrjetit kombëtar të mediatorëve shëndetësorë
- Standardizimi dhe certifikimi i detyrueshëm i mediatorëve, përmes zhvillimit dhe zbatimit të një programi kombëtar trajnimi dhe akreditimi
- Formalizimi i marrëdhënies së punës së mediatorëve, përmes kontratave të rregullta dhe përfshirjes së tyre në strukturat e Kujdesit Shëndetësor Parësor
- Rritja progresive e përfaqësimit të profesionistëve romë dhe egjiptianë në sistemin shëndetësor
- Zbatimi i një programi të dedikuar bursash dhe kuotash pranimi në arsimin mjekësor dhe teknik shëndetësor, për studentët romë dhe egjiptianë.

Rezultatet e pritshme deri në 2030:

Funksionimi i një rrjeti të qëndrueshëm mediatorësh shëndetësorë që rrit aksesin, besimin dhe përfaqësimin e komuniteteve rome dhe egjiptiane në sistemin shëndetësor.

Indikatorë të matshëm:

1. Pozicioni i mediatorit shëndetësor i miratuar zyrtarisht me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) dhe i përfshirë në strukturat organike të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
2. % e mediatorëve të punësuar nga komuniteti romë dhe egjiptian.

Objektivi III.3 “fuqizimi i informimit, edukimit dhe sensibilizimin mbi shëndetin në komunitetet rome dhe egjiptiane”, është thelbësor për rritjen e kërkesës për shërbime parandaluese, përmirësimin e shëndetit maternal dhe neonatal dhe forcimin e autonomisë shëndetësore të komuniteteve. Deri në vitin 2030 do të synohet rritja e ndjeshme e nivelit të njohurive shëndetësore në komunitet.

Për më tepër, krizat e fundit të shëndetit publik, përfshirë pandeminë COVID-19, kanë theksuar rëndësinë e sigurisë shëndetësore, ndërtimit të besimit dhe komunikimit efektiv të riskut si elementë thelbësorë të politikave të përfshirjes. Në kontekstin shqiptar, pabarazitë në aksesin ndaj shërbimeve shëndetësore, të kombinuara me sfida të vazhdueshme lidhur me besimin ndaj vaksinimit dhe ekspozimin ndaj dezinformimit, tregojnë nevojën për një qasje të integruar dhe të koordinuar ndërsektoriale, me qëllim forcimin e qëndrueshmërisë dhe reziliencës së komuniteteve rome dhe egjiptiane

Në këtë kuadër, Plani mund të forcohet më tej përmes integrimit të një Kuadri për Sigurinë Shëndetësore në Komunitet, në përputhje me parimet e Komunikimit të Riskut dhe Angazhimit të Komunitetit (RCCE) të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Një qasje e tillë do të mund të përfshinte hartimin e strategjive të synuara të komunikimit të riskut, forcimin e rrjeteve të ndërmjetësve komunitarë të besuar, si dhe organizimin e ushtrimeve të gatishmërisë dhe simulimeve për menaxhimin e krizave.

Kjo nuk do të kërkonte ngritjen e strukturave të reja, por do të mbështetej mbi mekanizmat ekzistues, me synim rritjen e përgatitjes institucionale, forcimin e besimit ndaj institucioneve publike dhe sigurimin e reagimeve më efektive në rast emergjencash të ardhshme shëndetësore. Përvoja e tërmetit shkatërrues të vitit 2019 dhe fatkeqësive të tjera natyrore, të cilat prekin në mënyrë disproporcionale komunitetet rome dhe egjiptiane, përbën një argument shtesë për nevojën e integrimit të kësaj qasjeje në Plan.

Fushëveprimi i objektivit specifik III.3 përfshin:

- Prodhimin dhe shpërndarjen e materialeve informuese në gjuhë të thjeshtuar dhe të përshtatur kulturalisht, përfshirë gjuhën rome, për të garantuar akses të barabartë në informacion.
- Organizimin e sesioneve edukative të strukturuara dhe të matshme mbi rëndësinë e vaksinimit, kujdesit neonatal dhe përdorimin e shërbimeve parandaluese.

- Zhvillimin e fushatave informuese mbi sistemin e referimit dhe aksesin në shërbime përmes platformës e-Albania, me mbështetjen e mediatorëve shëndetësorë.
- Përdorimin e metodave inovative të komunikimit (video, materiale vizuale, komunikim ndërkulturor) për tejkalimin e barrierave të shkrim-leximit dhe gjuhës.

- Përfshirjen aktive të grave, të rinjve dhe burrave në sesione të dedikuara për edukim shëndetësor, me fokus në shëndetin maternal

Rezultatet e pritshme deri në 2030:

Rritje e nivelit të informimit dhe ndërgjegjësimit shëndetësor, e reflektuar në përdorim më të lartë të shërbimeve parandaluese dhe të kujdesit maternal.

Indikatorë të matshëm:

1. Numri i materialeve të prodhuara dhe të shpërndara
2. % e pjesëmarrësve që raportojnë rritje të njohurive mbi rëndësinë e vaksinimit dhe kujdesit ndaj foshnjave.

Objektivi i fundit, III. 4 synon reduktimin e përhapjes së sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe përmirësimin e shëndetit riprodhues në komunitetet rome dhe egjiptiane, përmes informimit, diagnostikimit dhe trajtimit falas, si dhe forcimit të parandalimit dhe zbulimit të hershëm. Ky objektiv është thelbësor për mbrojtjen e shëndetit publik dhe minimizimin e pasojave afatgjata në shëndetin riprodhues, veçanërisht tek të rinjtë dhe gratë.

Në kuadër të objektivit specifik III. 4, janë planifikuar masat prioritare si më poshtë:

- Zhvillimi i fushatave sensibilizuese që adresojnë tabutë kulturore dhe stigmatizimin;
- Organizimi i sesioneve edukative për të rinjtë mbi planifikimin familjar;
- Garantimi i trajtimit falas, konfidencialitetit dhe ndjekjes së rasteve deri në shërim të plotë;
- Integrimi i shërbimeve të shëndetit riprodhues me mbështetje psikologjike dhe sociale.

Rezultatet e pritshme deri në 2030:

Ulja e ndjeshme e përhapjes së SST-ve dhe përmirësimi i treguesve të shëndetit riprodhues në komunitetet rome dhe egjiptiane.

Indikatorë të matshëm:

1. Numri i sesioneve edukative të realizuara në komunitet
2. % e barnave të rimbursuara të marra me sukses nga pacientët.

## Fusha: Arsimi dhe nxitja e dialogut ndërkulturor

Objektivi i parë IV. 1 synon *garantimin e aksesit, pjesëmarrjes së rregullt dhe përfundimit të arsimit nga fëmijët, nxënësit dhe studentët romë dhe egjiptianë,* duke adresuar në mënyrë të qëndrueshme barrierat ekonomike, sociale dhe institucionale që ndikojnë në braktisjen e hershme dhe ndërprerjen e arsimimit. Duke pasur parasysh se pabarazitë arsimore shfaqen që në arsimin parashkollor dhe thellohen gjatë gjithë

ciklit shkollor, romët dhe egjiptianët përbëjnë një grup prioritar për ndërhyrje të integruara që synojnë barazinë e mundësive dhe përfshirjen e qëndrueshme në sistemin arsimor.

Për të zhvilluar një qasje gjithëpërfshirëse ndaj arsimit, është planifikuar që politikat arsimore të shoqërohen me masa mbështetëse sociale dhe financiare, si dhe me mekanizma bashkëpunimi ndërinstitucional midis institucioneve arsimore, strukturave të mbrojtjes sociale dhe njësive të vetëqeverisjes vendore.

Si pjesë e objektivit specifik IV.1, janë planifikuar masa prioritare që lidhen me:

- Identifikimi dhe regjistrimi në kohë i fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsimin parashkollor dhe bazë.
- Zbatimi i programeve mbështetëse pas mësimit nëpërmjet shkollave si qendër komunitare për arsimin bazë dhe të mesëm.
- Zbatimi i programit të arsimit bazë me kohë të pjesshme për nxënësit jashtë sistemit arsimor.
- Përfshirja e gjuhës rome në kurrikulën arsimore

Rezultatet e pritshme deri në 2030:

Të rritet pjesëmarrja dhe përfundimi i arsimit nga fëmijët dhe nxënësit romë dhe egjiptianë nëpërmjet mbështetjes arsimore.

Indikatorë të matshëm:

1. Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë të regjistruar në arsimin parashkollor.
2. Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që përfitojnë transport falas.

Objektivi IV. 2 "*Krijimi i një sistemi arsimor të barabartë, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt cilësisë, i cili mundëson pjesëmarrjen e plotë të romëve dhe egjiptianëve në të gjitha nivelet e arsimit dhe garanton trajtim të barabartë pa diskriminim*", identifikon arsimin gjithëpërfshirës si një prioritet për uljen e braktisjes shkollore dhe përmirësimin e rezultateve arsimore. Për zhvillimin e një qasjeje sistemike ndaj arsimit gjithëpërfshirës, është planifikuar parandalimi i segregimit në shkolla, si dhe përmirësimi i mekanizmave të monitorimit dhe ndërhyrjes në nivel vendor.

Si pjesë e objektivit specifik IV. 2, janë planifikuar masa prioritare që lidhen me:

- Parandalimi dhe trajtimi i shkollave të segreguara, përmes mekanizmave të monitorimit.
- Identifikimi i nxënësve jashtë sistemit arsimor ose në rrezik braktisjeje dhe funksionalizimi i grupeve ndërsektoriale në nivel vendor.
- Referimi i familjeve në shërbimet e mbrojtjes sociale dhe skemat mbështetëse për përfundimin e arsimit bazë.
- Trajnimi dhe kualifikimi i mësuesve, psikologëve dhe punonjësve socialë për arsimin gjithëpërfshirës, diversitetin dhe antighipsizmin.
- Analizimi dhe rishikimi i kurrikulave dhe teksteve shkollore për eliminimin e stereotipave dhe përfshirjen e historisë dhe kulturës rome dhe egjiptiane.

- Trajnimi i mësuesve për zbatimin e kurrikulave të rishikuara.
- Zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulës së gjuhës rome në arsimin parauniversitar.

Rezultatet e pritshme deri në 2030:

- Të eliminohen shkollat e segreguara dhe të reduktohet ndjeshëm braktisja shkollore e nxënësve romë dhe egjiptianë.
- Të përmirësohet cilësia dhe gjithëpërfshirja në arsim për romët dhe egjiptianët përmes zhvillimit të kompetencave të stafit arsimor dhe rishikimit të kurrikulave.

Indikatorë të matshëm:

1. Përqindja e personelit arsimor të trajnuar për arsimin gjithëpërfshirës, diversitetin dhe antigjipsizmin.
2. Përqindja e kurrikulave dhe teksteve të rishikuara për përfshirjen e historisë dhe kulturës rome dhe egjiptiane.

Objektivi i tretë (IV. 3) synon rritjen e numrit dhe cilësisë së programeve, projekteve dhe aktiviteteve publike që promovojnë kulturën rome dhe egjiptiane, si dhe forcimin e përfaqësimit të romëve dhe egjiptianëve në institucionet publike të kulturës. Duke pasur parasysh se mungesa e përfaqësimit kulturor dhe narrativat stereotipizuese kontribuojnë në përjashtimin social dhe diskriminimin, ky objektiv e trajton kulturën si një instrument kyç për përfshirjen, dialogun ndërkulturor dhe ndërtimin e kohezionit shoqëror.

Për zhvillimin e një qasjeje të qëndrueshme në promovimin e trashëgimisë kulturore rome dhe egjiptiane, janë planifikuar masat e mëposhtme:

- Organizimi i festivaleve, panaireve, ekspozitave dhe eventeve përkujtimore në nivel kombëtar dhe vendor.
- Përfshirja e aktiviteteve për kulturën rome dhe egjiptiane në kalendarët kulturorë të institucioneve publike.
- Realizimi i programeve mediatike dhe dokumentarëve në mediat publike.
- Përcaktimi i fondeve të dedikuara për projektet kulturore të romëve dhe egjiptianëve.
- Mbështetja e botimeve dhe materialeve kulturore në gjuhët e pakicave.
- Nxitja e punësimit të profesionistëve romë dhe egjiptianë në institucionet e kulturës.
- Përfshirja e profesionistëve romë dhe egjiptianë në projektet dhe programet kulturore publike.

Rezultatet e pritshme deri në 2030:

Të rritet ndjeshëm prania e kulturës rome dhe egjiptiane në programet publike kulturore dhe në institucionet e kulturës, krahasuar me vitin 2025.

Indikatorë të matshëm:

1. Numri i aktiviteteve kulturore dhe artistike që promovojnë kulturën rome dhe egjiptiane.
2. Numri i projekteve të financuara për organizatat rome dhe egjiptiane.

## Fusha: Punësimi dhe aftësimi

Objektivi V. 1 synon *rritjen e pjesëmarrjes së romëve dhe egjiptianëve në shërbimet e punësimit, formimin profesional dhe programet aktive të tregut të punës*, me qëllim rritjen e punësimit të qëndrueshëm dhe kalimin gradual nga ekonomia informale drejt punësimit formal. Duke marrë parasysh nivelin e ulët të përfshirjes së këtyre komuniteteve në shërbimet publike të punësimit dhe pengesat që lidhen me mungesën e informacionit, aftësive dhe ndërmjetësimit institucional, ky objektiv e vendos fokusin në afrimin aktiv të shërbimeve tek komunitetet dhe ndërtimin e trajektoreve reale të integrimit në tregun e punës.

Masat për këtë objektiv do të synojnë ofrimin sistematik të shërbimeve të këshillimit, orientimit në karrierë dhe regjistrimit si punëkërkues për romët dhe egjiptianët, si dhe rritja e pjesëmarrjes së tyre në programet e formimit profesional publik dhe privat, përfshirë kurset për aftësi digjitale dhe sektorët me kërkesë në tregun e punës. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet mbështetjes së të rinjve për ndjekjen dhe përfundimin e arsimit të mesëm profesional, si dhe parandalimit të braktisjes së formimit profesional.

Objektivi, gjithashtu përcakton masa për rritjen e nivelit të punësimit të romëve dhe egjiptianëve pjesëmarrës në këto programe, përmes zgjerimit të përfshirjes në masat e nxitjes së punësimit, praktikat profesionale, formimin në punë dhe skemat e Garancisë Rinore.

Rezultatet e pritshme deri në vitin 2030:

- Të rritet pjesëmarrja e romëve dhe egjiptianëve në shërbimet e punësimit, formimin profesional dhe programet aktive të tregut të punës.
- Të rritet niveli i punësimit të romëve dhe egjiptianëve pjesëmarrës në formimin profesional dhe programet e nxitjes së punësimit.
- Të rritet përfshirja e romëve dhe egjiptianëve në skemat mbështetëse dhe mekanizmat e riintegrimit social, nga ndihma ekonomike drejt punësimit.

Indikatorë të matshëm:

1. Numri i romëve dhe egjiptianëve të cilët kanë marrë shërbime këshillimi dhe orientimi për karrierë
2. Numri i romëve dhe egjiptianëve të cilët janë regjistruar për herë të parë si punë kërkues te papune pu pa (hyrje të reja)
3. Numri i romëve dhe egjiptianëve të përfshirë në programet aktive të tregut të punës (PNP).

Objektivi i dytë V.2 lidhet me *fuqizimin ekonomik të romëve dhe egjiptianëve përmes mbështetjes së vetëpunësimit, zhvillimit të sipërmarrjes sociale dhe integrimit në sektorët e ekonomisë së gjelbër*, si alternativa të qëndrueshme ndaj punësimit informal dhe të pasigurt. Duke marrë parasysh potencialin ekonomik ekzistues në komunitete, por edhe barrierat që lidhen me aksesin në financim, formalizim dhe tregje. Ky objektiv fokusohet në krijimin e mundësive reale për gjenerimin e të ardhurave të qëndrueshme.

Në kuadër të këtij objektivi, do të synohet zgjerimi i skemave të granteve"start-up", kredive të buta dhe programeve të mentorimit për sipërmarrësit romë dhe egjiptianë, si dhe asistenca ligjore dhe teknike për regjistrimin dhe certifikimin e ndërmarrjeve me masa mbështetëse në nivel vendor, përfshirë lehtësitë

fiskale, formalizimin e tregtisë ambulatore dhe sipërmarrjes sociale. Objektivi parashikon edhe krijimin e hapësirave të dedikuara për tregtim në tregjet publike.

Një element kyç i këtij objektivi është tranzicioni nga ekonomia informale drejt punësimit të rregullt dhe të gjelbër, me fokus në sektorët e riciklimit, menaxhimit të mbetjeve dhe energjisë së rinovueshme.

Rezultatet e pritshme deri në 2030:

- Të rritet qëndrueshmëria ekonomike e familjeve rome dhe egjiptiane përmes zgjerimit të skemave të vetëpunësimit dhe integrimit të tyre në modele të sipërmarrjes sociale, duke rritur numrin e bizneseve të reja nga këto komunitete
- Të është arritur një tranzicion efektiv i punëkërkuesve romë dhe egjiptianë nga ekonomia informale drejt punësimit të rregullt e të gjelbër, me fokus në sektorët e riciklimit, menaxhimit të mbetjeve dhe energjisë së rinovueshme.

Indikatorë të matshëm:

1. Përqindja e ndërmarrjeve sociale të regjistruara me pronësi ose drejtim nga individë romë dhe egjiptianë .
2. Numri i individëve romë dhe egjiptianë që përfitojnë mbështetje financiare (grante ose kredi të buta) për vetëpunësim dhe zhvillim biznesi.

Objektivi i tretë V.3 *"Përmirësimi i kapaciteteve institucionale dhe rritja e cilësisë së shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional, për të garantuar integrimin efektiv të romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës"* fokusohet në forcimin e standardeve profesionale, etike dhe gjithëpërfshirëse të shërbimeve të ofruara.

Në këtë kuadër, parashikohet organizimi i trajnimeve të detyrueshme për stafin e zyrave të punësimit, qendrave dhe shkollave të formimit profesional mbi diversitetin, antigjipsizmin dhe trajtimin e barabartë, si dhe forcimi i mekanizmave institucionalë për të parandaluar dhe adresuar trajtimin e diskriminimit në tregun e punës. Paralelisht, do të zhvillohen aktivitete ndërgjegjësuese me punëdhënësit dhe partnerët e tregut të punës për promovimin e punësimit pa diskriminim.

Një element thelbësor i këtij objektivi është institucionalizimi i ndërmjetësimit komunitar si mekanizëm kyç për aksesin në tregun e punës, përmes punësimit dhe trajnimit të mediatorëve romë dhe egjiptianë pranë zyrave të punësimit.

Rezultatet e pritshme deri në 2030:

- Shërbime institucionale me standarde të larta etike dhe profesionale në trajtimin e pakicave rome dhe egjiptiane
- Institucionalizimi i ndërmjetësimit komunitar si mekanizëm kyç për aksesin në tregun e punës.

Indikatorë të matshëm:

1. Numri i romëve dhe egjiptianëve të licencuar për aktivitete ekonomike ambulatore ose të integruar në tregje publike të dedikuara.
2. Numri i individëve dhe subjekteve rome dhe egjiptiane të angazhuar formalisht në riciklim, menaxhim mbetjesh dhe sipërmarrje të gjelbra.

## Fusha: Mbrojtja Sociale

Objektivi VI.1 "*Fuqizimin e sistemit të mbrojtjes sociale për të siguruar mbulim më të gjerë, shërbime të integruara komunitare dhe qëndrueshmëri ndaj krizave për familjet rome dhe egjiptiane".* Duke marrë parasysh nivelin e lartë të varfërisë, pasigurisë ekonomike dhe ekspozimit ndaj rreziqeve sociale dhe mjedisore, ky objektiv fokusohet në forcimin e rolit të mbrojtjes sociale si instrument kyç për parandalimin e përjashtimit social dhe nxitjen e riintegrimit socio-ekonomik.

Në kuadër të këtij objektivi, masat prioritare janë:

- Përmirësimi i aksesit në NE dhe subvencione (energji, arsim, shëndetësi).
- Zbatimi i Planeve Individuale të Riintegrimit nëpërmjet referimit drejt punësimit/shërbimeve.
- Hartimi politika vendore lehtësuese për aksesin në shërbimet e fëmijërisë së hershme.
- Ngritja e shërbimeve lëvizëse (Mobile Units) dhe ndërmjetësimit komunitar në zona të izoluara.
- Forcimi i Mekanizmit të Referimit për rastet e dhunës në familje dhe trafikimit.
- Menaxhimi multidisiplinar i rasteve për fëmijët në situatë rruge dhe fuqizimi i familjeve të tyre
- Fushata ndërgjegjësuese në gjuhën rome për rreziqet nga pandemitë dhe mbrojtjen civile (përmbytje, zjarre, erozion).
- Krijimi i bazës së të dhënave për familjet më të rrezikuara për shpërndarjen e shpejtë të ndihmave në të emergjencave civile.
- Identifikimi i vendbanimeve rome në rrezik erozioni dhe planifikimi i masave mbrojtëse ose zhvendosjes emergjente.
- Forcimi i kapaciteteve të njësive vendore për menaxhimin e rasteve dhe ofrimin e shërbimeve sociale të integruara.
- Përmirësimi i aksesit në skemat e aftësisë së kufizuar dhe shërbimet mbështetëse.
- Zhvillimi i shërbimeve parandaluese për familjet në rrezik për të reduktuar institucionalizimin dhe përjashtimin social.

Rezultatet e pritshme deri në 2030:

- Fuqizimi i skemave të mbrojtjes financiare dhe tranzicioni drejt riintegrimit aktiv.
- Zgjerimi i shërbimeve sociale të integruara dhe mbrojtja e grupeve në rrezik (fëmijët/trafikimi).
- Rritja e qëndrueshmërisë ndaj krizave, pandemive dhe fatkeqësive natyrore.

Indikatorë të matshëm:

1. Numri i bashkive që financojnë shërbime për romët dhe egjiptianët përmes Fondit Social.
2. Numri i fëmijëve në situatë rruge dhe familjeve të trajtuara nga skuadrat e terrenit.

Objektivi VI.2, " *Forcimi i rolit te sistemit te mbrojtjes sociale ne identifikimin, referimin dhe riintegrimin e viktimave te trafikimit dhe shfrytezimit, permes menaxhimit te rasteve dhe ofrimit te sherbimeve sociale te integruara"*

Në kuadër të këtij objektivi, synohet realizimi i masave të mëposhtme:

- Trajnimi i punonjësve socialë dhe ekipeve multidisiplinare në nivel vendor për identifikimin e hershëm, vlerësimin dhe menaxhimin e rasteve të personave në rrezik trafikimi, me fokus të veçantë në komunitetet rome dhe egjiptiane.
- Forcimi i koordinimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet shërbimeve sociale vendore, strukturave të mbrojtjes së fëmijëve dhe mekanizmave kombëtarë të referimit, për të siguruar identifikim dhe referim efektiv të rasteve.
- Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe parandaluese në komunitetet rome dhe egjiptiane për të reduktuar faktorët e rrezikut që lidhen me trafikimin dhe shfrytëzimin, nëpërmjet ndërmjetësimit komunitar dhe shërbimeve sociale vendore.
- Krijimi i skuadrave shumëdisiplinore në bashkitë me risk.

Rezultatet e pritshme deri në 2030 janë:

Të përmirësohet ndjeshëm identifikimi, mbrojtja dhe ri-integrimi i romëve dhe egjiptianëve në rrezik trafikimi ose shfrytëzimi.

Indikatorë të matshëm:

1. Numri i anëtarëve të ekipeve shumëdisiplinore të trajnuar për menaxhimin e rasteve të trafikimit.
2. Numri i viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit të identifikuara dhe të asistuara.

## Fusha: Antigjipsizmi

Objektivi VII. 1 *Synon integrimin e konceptit të antigjipsizmit në kuadrin ligjor, strategjik dhe në praktikat institucionale të administratës publike, si bazë për parandalimin dhe adresimin sistematik të diskriminimit ndaj romëve dhe egjiptianëve*. Duke marrë parasysh mungesën e trajtimit të qartë dhe të unifikuar të antigjipsizmit në politikat publike, ky objektiv fokusohet në kthimin e angazhimeve politike në standarde konkrete, mekanizma funksionalë dhe përgjegjësi institucionale.

Për zhvillimin e një qasjeje të qëndrueshme institucionale kundër antighipsizmit, janë planifikuar masat e mëposhtme:

- Përcaktimi zyrtar i terminologjisë së "antigjhipsizmit" dhe integrimi i saj në dokumenta politikë, ligjorë dhe strategjitë sektoriale;
- Ngritja e mekanizmave për identifikimin dhe monitorimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në politikat publike;
- Hartimi dhe akreditimi i modulit të detyrueshëm të trajnimit mbi antigjipsizmin në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për punonjësit e nivelit qendror dhe vendor;
- Zhvillimi i seancave informuese dhe trajnimeve tematike për vendimmarrësit politikë mbi parimet e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit.

Rezultatet e pritshme deri në 2030:

Shumica e institucioneve publike të kenë integruar masa kundër antigjipsizmit në politikat dhe praktikat e tyre institucionale.

Indikatorë të matshëm:

1. Kurrikula për antigjipsizmin e miratuar dhe zbatuar në Shkollën e Administratës Publike.
2. Numri i punonjësve të Administratës Publike të trajnuar për antigjipsizmin.

Objektivi VII.2 lidhet me *rritjen e ndërgjegjësimit publik për të drejtat, historinë dhe kontributin e romëve dhe egjiptianëve në shoqërinë shqiptare*, si instrument kyç për luftimin e stereotipave, paragjykimeve dhe narrativave përjashtuese. Duke qenë se perceptimet negative dhe mungesa e përfaqësimit pozitiv kontribuojnë drejtpërdrejt në diskriminim dhe përjashtim social, ky objektiv e trajton ndërgjegjësimin publik si një element thelbësor të parandalimit të antixgjipsizmit.

Si pjesë e objektivit specifik VII.2 janë planifikuar këto masa prioritare:

- Organizimi i aktiviteteve kulturore periodike (ekspozita, botime, festivale) që promovojnë kontributin historik dhe bashkëkohor të romëve dhe egjiptianëve;
- Zhvillimi i programeve dhe fushatave mediatike kombëtare për luftimin e stereotipave dhe promovimin e modeleve pozitive nga komunitetet;
- Implementimi i fushatave informuese mbi të drejtat e njeriut, mekanizmat e mbrojtjes nga diskriminimi dhe konceptin e antigjipsizmit;
- Zhvillimi i sesioneve informuese "derë më derë" dhe aktiviteteve komunitare për fuqizimin e vetëbesimit dhe njohurive ligjore të romëve dhe egjiptianëve.

Rezultatet e pritshme deri në 2030:

Do të rritet ndjeshëm prania e temave që lidhen me historinë, kulturën dhe të drejtat e romëve dhe egjiptianëve në edukim dhe në hapësirën publike.

Indikatorë të matshëm:

1. Numri i aktiviteteve publike ndërgjegjësuese të realizuara në nivel kombëtar dhe vendor.
2. Numri i personave të informuar mbi konceptin e antigjipsizmit.

Objektivi i fundit, VII.3, synon garantimin e mbrojtjes ligjore të barabartë dhe rritjen e pjesëmarrjes së romëve dhe egjiptianëve në vendimmarrjen lokale dhe kombëtare, si element kyç për luftimin e diskriminimit dhe forcimin e demokracisë gjithëpërfshirëse. Duke marrë parasysh nivelin e ulët të raportimit të krimeve të urrejtjes dhe përfaqësimin e kufizuar në proceset vendimmarrëse, ky objektiv fokusohet në forcimin e reagimit institucional dhe fuqizimin e zërit të komuniteteve.

Për adresimin, realizimin dhe arritjen e objektivit specifik, përfshihen masat e mëposhtme prioritare:

- Ofrimi i ndihmës ligjore falas dhe mbështetjes për viktimat e gjuhës dhe krimeve të urrejtjes;
- Trajnimi i profesionistëve të sistemit të drejtësisë dhe forcave të rendit mbi identifikimin dhe trajtimin e antigjipsizmit;

- Ngritja e sistemeve të mbledhjes së të dhënave dhe raportimit periodik mbi incidentet me bazë urrejtjeje;
- Nxitja e pjesëmarrjes së romëve dhe egjiptianëve në proceset zgjedhore dhe forumet vendimmarrëse;
- Krijimi i mekanizmave të bashkë-monitorimit midis institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile;
- Implementimi i skemave të financimit publik të dedikuara për fuqizimin e organizatave rome dhe egjiptiane.

Rezultatet e pritshme deri në 2030:

Të forcohet ndjeshëm mbrojtja ligjore kundër diskriminimit dhe të rritet pjesëmarrja e romëve dhe egjiptianëve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal dhe kombëtar.

Indikatorë të matshëm:

1. Përqindja e policëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve të certifikuar për trajtimin e krimeve me bazë urrejtjeje.
2. Numri i viktimave që përfitojnë ndihmë juridike falas dhe mbështetje psiko-sociale.

## 2. 4 Mekanizmat e zbatimit, monitorimit dhe raportimit

## Zbatimi i planit

Zbatimi i PKVBPPRE 2026–2030 do të mbështetet në një qasje të integruar dhe ndërsektoriale, të harmonizuar me Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI), si mekanizmi kryesor kombëtar për orientimin strategjik dhe alokimin e burimeve publike. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ushtron rolin drejtues dhe koordinues për zbatimin e Planit, ndërsa Drejtoria e Politikave të Përfshirjes Sociale siguron koordinimin ndërinstitucional dhe ndjekjen e zbatimit të masave në nivel kombëtar.

Zbatimi do të realizohet përmes decentralizimit të përgjegjësive dhe bashkëpunimit përmes përfshirjes aktive të pikave të kontaktit si: ministritë e linjës, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqëria civile, mbështetjes së aktorëve ndërkombëtarë, të cilat do të mbledhin dhe konsolidojnë të dhënat përkatëse, si dhe do të adresojnë boshllëqet e identifikuara në informacion. Bashkëpunimi dhe ndërveprimi rajonal, qendror dhe vendor do të forcohet për të garantuar koherencë në zbatim, përmirësim të mbledhjes së të dhënave, monitorim efektiv të ndërhyrjeve dhe vlerësim të vazhdueshëm në shtyllat kryesore të Planit.

## Monitorimi dhe raportimi

Monitorimi i PKVBPPRE 2026–2030 do të shërbejë si instrument kyç për orientimin e politikave publike brenda SPI-së dhe për informimin e proceseve vendimmarrëse në kuadër të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave dhe Nën-Grupit Tematik për Përfshirjen Sociale, të udhëhequr nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Procesi i monitorimit do të realizohet përmes sistemit elektronik onlineROMALB, konsultimeve periodike nëpërmjet platformave të dialogut për mundësuar harmonizimin e statistikave dhe përmirësimin e cilësisë së raporteve të progresit. Raportet vjetore të monitorimit do të përgatiten dhe publikohen çdo vit brenda muajit mars të vitit pasardhës. Ato do të diskutohen në grupet

tematike përkatëse, duke garantuar transparencë, llogaridhënie dhe përdorim efektiv të të dhënave për përmirësimin e politikave sociale në nivel qendror.

Drejtoria e Politikave të Përfshirjes Sociale pranë MSHMS-së do të ndërmarrë masa për trajnimin dhe ofrimin e asistencës teknike të vazhdueshme për përdoruesit e sistemit elektronik ”ROMALB”, në lidhje me regjistrimin, përditësimin dhe administrimin e të dhënave të treguesve të monitorimit. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ushtron rolin koordinues për zbatimin e PKVBPPRE 2026-2030, ndërsa Drejtoria e Politikave të Përfshirjes Sociale, brenda kësaj Ministrie, është përgjegjëse për monitorimin ndërsektorial të zbatimit të Planit dhe për hartimin e raporteve periodike të progresit.

Organizatat e shoqërisë civile, veçanërisht ato që përfaqësojnë pakicat rome dhe egjiptiane, do të përfshihen në monitorim përmes aksesit të strukturuar në sistemin ROMALB dhe pjesëmarrjes aktive në mekanizmat e bashkëpunimit ndërinstitucional.

### Vlerësimi

Në përfundim të periudhës së zbatimit të PKVBPPRE 2026–2030 do të hartohet një raport përmbledhës përfundimtar i vlerësimit, i cili do të finalizohet në muajin mars 2031. Ky proces do të fokusohet në analizën pesëvjeçare të performancës së treguesve, vlerësimin e rezultateve dhe ndikimit të masave të zbatuara, si dhe në identifikimin e mësimeve të nxjerra, praktikave të mira dhe historive të suksesit.

Vlerësimi do të mbështetet në të dhënat e gjeneruara nga sistemi ROMALB, raportet vjetore të monitorimit, kontributet e institucioneve publike dhe të shoqërisë civile, si dhe në përfshirjen aktive të pakicave rome dhe egjiptiane. Gjetjet e vlerësimit do të përdoren për përmirësimin e politikave publike për përfshirjen sociale dhe për orientimin e ndërhyrjeve strategjike të ardhshme, në përputhje me prioritetet kombëtare të zhvillimit dhe procesin e integrimit evropian.

## 2. 5 Përgjegjësitë institucionale

PKVBPPRE 2026–2030 përcakton qartë përgjegjësitë institucionale për zbatimin e tij, duke përfshirë ministritë e linjës në fushat e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, arsimit, financave, ekonomisë, drejtësisë, punëve të brendshme, kulturës, turizmit dhe sportit, si dhe institucione të pavarura dhe mbështetëse si INSTAT, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komiteti i Pakicave Kombëtare, Kuvendi i Shqipërisë dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Koordinimi i përgjithshëm i Planit realizohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, përmes strukturave përgjegjëse për përfshirjen sociale dhe monitorimin e politikave, në bashkëpunim me grupe teknike ndërsektoriale të përbëra nga përfaqësues të institucioneve përgjegjëse. Këto struktura shërbejnë si platforma për shkëmbimin e informacionit, ofrimin e kontributeve teknike dhe monitorimin e progresit, duke raportuar rregullisht pranë mekanizmave ndërministrorë. Në nivel vendor, forcimi i mekanizmave të monitorimit do të realizohet përmes pikave të kontaktit në bashki, të cilat luajnë rol kyç në mbledhjen e të dhënave, adresimin e diskriminimit dhe lehtësimin e aksesit në shërbime publike, me qëllim garantimin e ushtrimit të barabartë të të drejtave të romëve dhe egjiptianëve.

## 2.6 Indikatorët e performancës

**Fusha I: Akses i barabartë në drejtësi dhe në regjistrim civil**

Treguesi kryesor i performancës do të jetë *numri i romëve dhe egjiptianëve që përfitojnë ndihmë juridike parësore dhe dytësore,* i shoqëruar me zgjerimin e *pikave/zyrave vendore të ndihmës juridike* në bashkitë me përqendrim të lartë. Paralelisht, do të matet progresi përmes numrit të personave (fëmijë dhe të rritur) të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe numrit të familjeve që rregullojnë vendbanimin përmes mekanizmave të lehtësuar. Për të garantuar zbatim real, tregues të rëndësishëm mbeten numri i procedurave të mbështetura financiarisht nga shteti (ADN, legalizime/përkthime) dhe përqindja e nëpunësve të gjendjes civile të trajnuar për trajtim pa diskriminim.

**Fusha II: Strehimi**
Në strehim, treguesit më të rëndësishëm matin *legalizimin/alternativat për legalizim dhe aksesin në strehim social*. Performanca do të vlerësohet së pari përmes numrit të banesave/objekteve të familjeve rome dhe egjiptiane të legalizuara ose të trajtuara me zgjidhje alternative (strehim, kompensim), si dhe përmes përqindjes së NJVV-ve që kanë plane strehimi aktive dhe të financuara. Një tregues i dytë kyç është *numri i familjeve që përfitojnë subvencionim qiraje, kredi të buta ose programe strehimi social,* sepse ky tregon kalimin nga zgjidhje të përkohshme drejt sigurisë së strehimit. Po aq i rëndësishëm është edhe numri i rasteve të zgjidhura përmes mekanizmave mbështetës financiarë, që parandalojnë humbjen e strehimit për shkak të pamundësisë ekonomike.

**Fusha III: Kujdesi shëndetësor**

Në shëndetësi, treguesit kryesor masin *mbulimin real me shërbime shëndetësore, funksionalizimin e rolit të mediatorëve shëndetësor dhe përmirësimin e shëndetit riprodhues*. Treguesi kryesor do të jetë numri i personave romë dhe egjiptianë të shërbyer në terren nga ekipe lëvizëse dhe shërbime pranë komunitetit, i shoqëruar nga numri i kontrolleve parandaluese (check-up) dhe depistimeve të kryera çdo vit. Për fëmijët, tregues kritik është *përqindja e vaksinimit të detyrueshëm sipas kalendarit kombëtar* sepse reflekton aksesin dhe besimin tek sistemi. Në nivel sistemi, do të maten miratimi dhe financimi i pozicionit të mediatorit shëndetësor, numri i mediatorëve të certifikuar dhe të punësuar, si dhe rritja e përfaqësimit të profesionistëve romë dhe egjiptianë në shëndetësi. Për shëndetin riprodhues dhe SST, tregues thelbësorë janë numri i testimeve konfidenciale, numri i personave që marrin trajtim të plotë dhe shtrirja e fushatave edukative në komunitet.

**Fusha IV: Arsimi dhe dialogu ndërkulturor**

Në fushën e arsimit, trajektorja arsimore vlerësohet kryesisht nëpërmjet treguesve të regjistrimit të fëmijëve/nxënësve, frekuentimit të procesit mësimor dhe përfundimit të shkollës. Treguesi kryesor është *numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë të regjistruar në arsimin parashkollor dhe numri i nxënësve që përfundojnë arsimin bazë*, përfshirë rrugët alternative për ata jashtë sistemit. Për vazhdimësinë, do të ndiqet numri i nxënësve që përfitojnë transport falas, mbështetjen përmes mediatorëve dhe përfitimin nga skemat financiare (bursa, ulje tarifash). Për cilësinë dhe barazinë, tregues kyç është *eliminimi i segregimit* (numri i shkollave të segreguara) *dhe reduktimi i braktisjes*, i shoqëruar me përqindjen e stafit të trajnuar për arsimin

gjithëpërfshirës dhe antigjipsizmin. Për dialogun ndërkulturor, treguesit më të rëndësishëm janë numri i aktiviteteve kulturore/edukuese dhe përfshirja e historisë/kulturës së komuniteteve rome dhe egjiptianenë kurrikul dhe tekste mësimore.

**Fusha V: Punësimi dhe aftësimi**

Në punësim, *treguesit kryesorë* matin *pjesëmarrjen në shërbime dhe programe, punësimin real dhe tranzicionin nga – ndihma ekonomike në punë*. Performanca do të matet me numrin e romëve dhe egjiptianëve të regjistruar si punëkërkues dhe të përfshirë në këshillim/orientim, si dhe me numrin e tyre të certifikuar në formim profesional. Tregues kyç është *numri i përfituesve që punësohen* përmes programeve aktive, praktikave dhe subvencionimit të punësimit, sepse ky tregon kalimin nga informaliteti në punë të rregullt. Po ashtu, do të matet numri i familjeve që kalojnë nga ndihma ekonomike në punësim/vetëpunësim. Për objektivat e fuqizimit ekonomik, treguesit thelbësor janë numri i individëve që marrin grante/kredi të buta, numri i ndërmarrjeve sociale të krijuara ose të drejtuara nga anëtarë të komuniteteve rome dhe egjiptiane, dhe përfshirja formale në sektorë të ekonomisë së gjelbër (riciklim, menaxhim mbetjesh, energji).

**Fusha VI: Mbrojtja sociale**

Në mbrojtje sociale, treguesit kryesorë matin *mbulimin e skemave, funksionimin e shërbimeve të integruara, dhe reagimin ndaj krizave.* Performanca do të vlerësohet *përmes numrit të familjeve rome dhe egjiptiane që dalin nga ndihma ekonomike përmes punësimit*, por edhe përmes *numrit të familjeve që përfitojnë mekanizma plotësues* kur mbeten jashtë sistemit të pikëzimit. Për shërbimet sociale, tregues kyç është numri i bashkive që financojnë shërbime të dedikuara për romët dhe egjiptianët, si dhe numri i fëmijëve në situatë rruge/familjeve të trajtuara nga skuadrat e terrenit. Për elementine krizave, treguesit më të rëndësishëm janë ekzistenca e protokolleve të emergjencës, identifikimi i familjeve në risk dhe përqindja e familjeve që marrin mbështetje të menjëhershme gjatë pandemive apo fatkeqësive. Për trafikimin/shfrytëzimin, tregues kryesor mbeten numri i rasteve të identifikuara dhe të asistuara dhe funksionimi i skuadrave shumëdisiplinore.

**Fusha VII: Antigjipsizmi**

Në antigjipsizëm, treguesit më të rëndësishëm matin ndryshimin institucional, ndërgjegjësimin publik dhe zbatimin e mbrojtjes ligjore. Tregues kyç është *numri i dokumentave ligjore/strategjike që e integrojnë termin dhe masat kundër antigjipsizmit*, i shoqëruar me *numrin e punonjësve publikë të trajnuar* përmes moduleve të standardizuara Në dimensionin publik, do të vlerësohet progresi përmes numrit të fushatave kombëtare/lokale dhe numrit të personave të informuar mbi të drejtat dhe mekanizmat e mbrojtjes. Për dimensionin e drejtësisë dhe llogaridhënies, treguesit më të rëndësishëm janë numri i rasteve të diskriminimit/krimeve të urrejtjes të ndjekura dhe të adresuara, përqindja e profesionistëve të drejtësisë të trajnuar dhe rritja e përfaqësimit të romëve dhe egjiptianëve në struktura vendimmarrëse, së bashku me fokusin financiar të dedikuar për organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në këtë drejtim (monitorim dhe avokim).

## 2.7 Vlerësimi i impaktit

Vlerësimi i impaktit të objektivave dhe qëllimeve të PKVBPPRE 2026-2030 bazohet në qasjen e orientuar drejt rezultateve dhe ndryshimit strukturor, siç parashikohet në Kornizën Strategjike të BE-së për Romët dhe në Strategjinë e Këshillit të Evropës. Në këtë kontekst, impakti nuk vlerësohet vetëm përmes arritjes së objektivave sektoriale, por përmes ndryshimit të qëndrueshëm të pabarazive strukturore, reduktimit të hendekut mes romëve, egjiptianëve dhe popullsisë së përgjithshme, si dhe forcimit të barazisë, përfshirjes dhe pjesëmarrjes domethënëse.

Në përputhje me strategjinë e BE-së, vlerësimi i impaktit fokusohet në aftësinë e Planit për të kontribuar në uljen e pabarazive në arsim, punësim, shëndetësi, strehim, mbrojtje sociale dhe aksesin në të drejta, duke matur progresin përmes treguesve të krahasueshëm në kohë dhe ndërmjet grupeve të popullsisë. Kjo qasje synon të vlerësojë nëse masat e ndërmarra prodhojnë ndryshime reale në jetën e përditshme të romëve dhe egjiptianëve dhe nëse ato kontribuojnë në përmirësimin e rezultateve afatgjata, përtej outputeve administrative.

Një element thelbësor i vlerësimit të impaktit është analiza e pjesëmarrjes domethënëse të romëve dhe egjiptianëve në proceset e vendimmarrjes dhe monitorimit, në përputhje me parimin"e përfshirjes". Impakti i zbatimit do të vlerësohet edhe përmes nivelit të përfshirjes së pakicave dhe organizatave të tyre përfaqësuese në zbatimin, monitorimin dhe rishikimin e masave të Planit, si dhe përmes ndikimit të kësaj pjesëmarrjeje në cilësinë dhe efektivitetin e politikave publike.

Vlerësimi i impaktit do të mbështetet në të dhëna sasiore dhe cilësore, duke kombinuar analizën e treguesve të Planit të Veprimit me të dhëna administrative, raportet e monitorimit, kontributet e shoqërisë civile dhe dëshmitë nga terreni. Kjo qasje e ndërthurur, e promovuar si nga BE-ja ashtu edhe nga Këshilli i Evropës, synon të sigurojë një vlerësim të plotë të impaktit socio-ekonomik, institucional dhe politik të ndërhyrjeve.

Në përfundim, vlerësimi i impaktit të PKVBPPRE 2026-2030 do të shërbejë jo vetëm për të matur arritjen e objektivave dhe qëllimeve të Planit, por edhe për të informuar rishikimin e politikave publike, përmirësimin e ndërhyrjeve dhe orientimin e strategjive të ardhshme në përputhje me prioritetet e integrimit evropian dhe standardet e Këshillit të Evropës për barazi, përfshirje dhe të drejta të njeriut.

# PJESA III - ANALIZA BUXHETORE

Analiza e buxhetit për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2026-2030

Ky seksion paraqet shpërndarjen e kostove treguese dhe burimet financiare për financimin e aktiviteteve të PKV për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2026-2030. Efektet financiare janë përllogaritur për çdo aktivitetet të Planin e Veprimit, duke mbajtur në konsideratë produktet dhe treguesit e përcaktuar për çdo aktivitet. Efektet financiare parashikohen të përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara me zbatimin e masave, nga buxhete të donatorëve dhe institucioneve të tjera që janë ngarkuar për zbatimin e një pjesë të masave, si dhe buxhetet e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Procesi i kostimit u mbështet në konsultimin e dokumentave të tjerë kombëtarë, konsultimet me të gjitha institucionet e përfshira, si dhe në kostot historike nga zbatimi i planit pararendës. Plani i veprimit shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë, i cili mbështetet nga detajimi i hollësishëm i shpenzimeve për çdo aktivitet. .Kostimi i PKV është realizuar në bazë të metodologjive dhe praktikave së planifikimit buxhetor, duke përdorur instrumentat e rekomanduar nga IPSIS.

Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e PKV për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2026 - 2030 është 1**,799,629,276 Lekë**, ose 1**8,363,564 Euro**. Kursi mesatar për referencë është përllogaritur me 98 lek për 1 euro. Tabela pasqyron kostot financiare, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë 5 viteve të zbatimit të PKV 2026 - 2030.

**Nevojat (në Lek)**

| Qëllimi i Politikave | Natyra/ Tipologjia e Kostove | Kostoja Totale 2026-2030 | Kostot e Planifikuara PBA 2026-2028 Buxheti dhe Donatoret | Kosto për tu Planifikuar në Buxhetin 2029-2030 | Hendeku Financiar 2026-2030 |
|---|---|---|---|---|---|
| P1: Akses i barabartë në drejtësi dhe në regjistrim civil | Korente | 18,026,875 | 26,654,044 | 13,980,640 | ***-22,607,809*** |
| | Kapitale | 0 | 0 | 0 | |
| P2: Sigurimi i strehimit dinjitosz dhe i qëndrueshëm për komunitetet romë dhe egjiptianë përmes formalizimit të vendbanimeve dhe integrimit në programet e strehimit social. | Korente | 66,869,251 | 36,864,106 | 19,844,544 | ***-23,894,399*** |
| | Kapitale | 412,720,000 | 268,065,000 | 178,710,000 | |
| P3: Garantimi i mbrojtjes së shëndetit dhe aksesit universal në shërbime shëndetësore cilësore për pakicat romë dhe egjiptianë, duke eliminuar pabarazitë në treguesit e jetëgjatësisë dhe mirëqenies. | Korente | 220,837,050 | 288,126,306 | 75,830,048 | ***-<br>143,119,304*** |
| | Kapitale | 0 | 0 | 0 | |
| P4: Forcimi i barazisë së mundësive në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për romët dhe egjiptianët, nga arsimi parashkollor deri në arsimin e lartë si dhe promovimi i dialogut ndërkulturor për romët dhe egjiptianët | Korente | 191,761,650 | 156,322,334 | 112,999,844 | ***-77,560,528*** |
| | Kapitale | 0 | 0 | 0 | |
| P5: Garantimi i aksesit të barabartë në tregun e punës dhe fuqizimi ekonomik i pakicave romë dhe egjiptianë përmes punësimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. | Korente | 342,337,800 | 135,753,604 | 77,591,764 | ***147,167,432*** |
| | Kapitale | 38,500,000 | 12,275,000 | 8,050,000 | |
| P6: Përmirësim i qasjes dhe rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianeve në programet e mbrojtjes sociale | Korente | 476,336,400 | 291,211,288 | 49,472,432 | ***135,652,680*** |
| | Kapitale | 0 | 0 | 0 | |
| P7: Garantimi i barazisë gjithëpërfshirëse dhe mbrojtjes nga diskriminimi për pakicat romë dhe egjiptianë, përmes forcimit të mekanizmave ligjorë, reformave institucionale dhe promovimit të një kulture shoqërore gjithëpërfshirëse. | Korente | 32,240,250 | 21,721,456 | 16,718,992 | ***-6,200,198*** |
| | Kapitale | 0 | 0 | 0 | |
| **TOTALI [Leke]** | | **1,799,629,276** | **1,236,993,138** | **553,198,264** | ***9,437,874*** |
| **TOTALI [Euro]**<br>***1 euro 98 Leke*** | | **18,363,564** | **12,622,379** | **5,644,880** | ***96,305*** |




Kostot korente zënë rreth 75.0% të shpenzimeve totale, ndërsa pjesa tjetër (25.0%) është e parashikuar për kosto kapitale.



Të ndara sipas qëllimeve të politikave, kostot pasqyrohen në grafikun më poshtë.




Plani Kombëtar Veprimit do të rishikohet pas 3 vitesh (në vitin 2028) për ta përshtatur me progresin në zbatimin e masave, por edhe për ta azhornuar atë konform nevojave dhe programeve buxhetore afatmesme 2029-2030, të çdo institucioni. Për masat të planit që janë të pambuluara financiarisht, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të programit afatmesëm buxhetor dhe buxhetit vjetor, si dhe do të negociojnë me donatorë të ndryshëm për t'i bashkëfinancuar disa aktivitete.

## ANEKSI 1: Matrica e Planit Kombëtar Të Veprimit Për Barazi, Përfshirje Dhe Pjesëmarrjen E Romëve Dhe Egjiptianëve 2026-2030

| **Fusha Prioritare I: Akses i barabartë në drejtësi dhe në regjistrim civil** | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qëllimi i Politikës I: Sigurimi i barazisë de facto në sistemin e drejtësisë dhe shërbimet civile, përmes eliminimit të barrierave ligjore, administrative dhe financiare për pakicat rome dhe egjiptiane.** | | | | | | | |
| **Objektivi I.1: Garantimi i integritetit civil të romëve dhe egjiptianëve përmes eliminimit të rasteve të paregjistruara dhe rregullimit të statusit të vendbanimit.** | | | | | | | |
| **Masat dhe Aktivitetet Kryesore** | **Treguesit e Performancës** | **Baseline[3] 2025** | **Target 2030** | **Rezultatet e Pritshme** | **Institucioni Përgjegjës** | **Institucionet Partnere** | **Afati Kohor** |
| Ofrimi i shërbimeve falas për legalizimin dhe përkthimin e dokumenteve të nevojshme për regjistrim civil. | Numri i familjeve që kanë rregulluar statusin e tyre civil përmes vërtetimit faktik të vendbanimit. | 0 | 1,500 familje të mbështetura | Deri në vitin 2030, arrihet regjistrimi universal i çdo lindjeje dhe përditësimi i adresave të vendbanimit për të gjitha familjet rome dhe egjiptiane, duke siguruar akses të plotë në shërbimet publike. | MPB / DPGjC | MPJ | 2026-2030 |
| Identifikimi në terren i personave të paregjistruar dhe asistimi i tyre në procedurat e dokumentimit (brenda dhe jashtë vendit). | Numri i personave (fëmijë dhe të rritur) të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. | 250 (fëmijë të identifikuar si të paregjistruar) | 500 të regjistruar rishtazi në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. | | MPB / Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGjC) | NJVV, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, Shërbimi Social Shtetëror, OJF rome/egjiptiane, MPJ (për raste jashtë vendit) | 2026-2030 |
| Zbatimi i mekanizmave që lejojnë regjistrimin e vendbanimit përmes | Numri i personave (fëmijë dhe të rritur) të regjistruar rishtazi në | 250 (fëmijë të identifikuar si të paregjistruar) | ≤100 (të ulen rastet e paregjistrimit me të paktën 60% krahasuar me 2025) | | MPB / DPGjC | NJVV, MD (ndihmë juridike), OJF rome/egjiptiane | 2026-2030 |

[3] Në mungesë të një vlere baseline të përcaktuar për vitin 2025 për një indikator të caktuar, ndërkohë që ekziston një target për vitin 2030, baseline do të përcaktohet mbi bazën e të dhënave të mbledhura dhe të raportuara në raportin e parë të monitorimit vjetor të zbatimit të Planit për atë indikator.

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| vërtetimeve faktike për familjet që banojnë në zona informale. | Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. | | | | | | |
| Thjeshtimi i procedurave administrative për transferimin e dosjes civile në bashkinë ku familja jeton aktualisht. | | | | | MPB/DPGjC | NJVV, MSHMS/SHSSH, OJF, e-Albania (AKSHI) | 2026-2030 |
| Thjeshtimi i procedurave administrative për transferimin e dosjes civile në bashkinë ku familja jeton aktualisht. | Numri i nëpunësve të gjendjes civile të trajnuar për trajtimin pa diskriminim të rasteve specifike të komunitetit. | 525 nëpunës të trajnuar | 800 nëpunës të trajnuar | | MPB / DPGjC | NJVV, MSHMS/SHSSH, OJF, e-Albania (AKSHI) | 2026-2030 |
| Zbatimi i mekanizmave që lejojnë regjistrimin e vendbanimit përmes vërtetimeve faktike për familjet që banojnë në zona informale. | Numri i testeve të ADN-së dhe procedurave të legalizimit të dokumenteve të financuara nga shteti. | 50 persona të rimbursuar për ADN + 270 legalizime falas nga konsullatat | 100 rimbursime ADN/vit dhe 400 legalizime falas/vit (rritje e aksesit në dokumente për regjistrim civil) | | MPB / DPGjC (ADN koordinim) dhe MPJ (legalizime konsullore) | Laboratorë të licencuar, MPJ/konsullata, OJF, NJVV | 2026-2030 |

| Objektivi I.2: Garantimi i mbrojtjes ligjore falas për romët dhe egjiptianët përmes thjeshtimit të procedurave dhe shtrirjes së shërbimeve në nivel vendor. | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Masat dhe Aktivitetet Kryesore** | **Treguesit e Performancës** | **Baseline 2025** | **Target 2030** | **Rezultatet e Pritshme** | **Institucioni Përgjegjës** | **Institucionet Partnere** | **Afati Kohor** |
| Ofrimi i asistencës juridike përmes klinikave ligjore dhe zyrave vendore të dedikuara. | Numri i personave romë dhe egjiptianë që kanë përfituar asistencë juridike (parësore dhe dytësore). | 1,500 | 3,000 | Deri në vitin 2030, qytetarët romë dhe egjiptianë përfitojnë mbrojtje juridike efektive (parësore dhe dytësore) pa asnjë barrierë financiare apo administrative. | MD/ Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas | Institucionet e Arsimit të Lartë (klinikat ligjore), NJVV, OJF të autorizuara | 2026-2030 |
| Krijimi i rrjetit të avokatëve të gatshëm për përfaqësim gjyqësor (ndihmë dytësore) për këto komunitete. | Numri i zyrave të reja të ndihmës juridike të hapura në bashkitë me përqendrim të lartë të komuniteteve. | 20 qendra/zyra funksionale të ndihmës juridike parësore në Tiranë, Lushnjë, Durrës, Shkodër, Fier, Gjirokastër, Tropojë, Përmet, Puka, Mati, Kavajë, Kurbin, Lezhë, Pogradec, Vlorë, Dibër, Kukës, Korçë, Berat, Elbasan; 14 (katërmbëdhjetë) organizata jo fitimprurëse, të | 25 qendra/zyra funksionale | | MD/ Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas | Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Shkolla e Magjistraturës, OJF | 2026-2030 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | cilat operojnë në Tiranë; Durrës; Elbasan; Berat; Shkodër dhe Vlorë të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë; 13 (trembëdhjetë) marrëveshje bashkëpunimi me klinikat ligjore pranë IAL-ve që operojnë në Tiranë; Durrës; Elbasan; Vlorë dhe Shkodër. | | | | | |
| Realizimi i fushatave informuese mbi të drejtat ligjore dhe procedurat e aplikimit për ndihmë falas. | Numri i grave dhe vajzave të informuara dhe të përfaqësuara në çështje të pronësisë dhe familjes. | 1,000 gra dhe vajza rome dhe egjiptiane të informuara/ vëzhguara ligjërisht. | 2,000 gra dhe vajza rome dhe egjiptiane të informuara/ vëzhguara ligjërisht. | | MD | NJVV, OJF rome dhe egjiptiane, media publike, Shërbimet Sociale | 2026-2030 |
| Amendimi i ligjit për ndihmën juridike për të lehtësuar kriteret e përfitimit për | Kuadri ligjor i rishikuar që njeh romët dhe egjiptianët si kategori përfituese automatike (ex-lege). | N/A | 1 paketë ligjore e miratuar | | MD | Kuvendi i Shqipërisë, MSHMS, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, OJF | 2026-2030 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| romët dhe egjiptianët. | | | | | | | |
| Ofrimi i sesioneve specifike për gratë dhe vajzat mbi të drejtat e tyre pronësore dhe trashëgiminë. | | | | | MD | MSHMS, NJVV, OJF të grave, struktura për barazinë gjinore | 2026-2030 |

| Fusha Prioritare II: Strehimi | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qëllimi i Politikës II: Sigurimi i strehimit dinjitoz dhe të qëndrueshëm për komunitetet rome dhe egjiptiane përmes formalizimit të vendbanimeve dhe integrimit në programet e strehimit social.** | | | | | | | |
| **Objektivi II.1: Konsolidimi i mekanizmave ligjorë dhe vendorë për përshpejtimin e legalizimit dhe zgjerimin e skemave të strehimit social për familjet rome dhe egjiptiane.** | | | | | | | |
| **Masat dhe Aktivitetet Kryesore** | **Treguesit e Performancës** | **Baseline 2025** | **Target 2030** | **Rezultatet e Pritshme** | **Institucioni Përgjegjës** | **Institucionet Partnere** | **Afati Kohor** |
| Asistencë teknike për bashkitë në hartimin e planeve 5-vjeçare të strehimit dhe aplikimin për fonde pranë Ministrisë përgjegjëse. | Numri i familjeve që përfitojnë subvencionim të plotë të qirasë (bonus strehimi) ose kredi të buta. | 65 familje (shërbime shtesë/mbështetje për pamundësi pagese në programe strehimi) | 300 familje përfituese (bonus qiraje/kredi e butë + paketë mbështetjeje) deri në 2030 | Deri në vitin 2030, të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) kanë kapacitete të plota operative dhe buxhetore për të adresuar nevojat për strehim të komuniteteve, duke eliminuar rastet e mungesës se strehimit dhe pasigurisë së pronësisë. | MEI / EKB | NJVV, MSHMS/SHSSH, Zyrat e Punësimit, Bankat (për kredi të butë), OJF | 2026-2030 |
| Përshpejtimi i procedurave të legalizimit për banesat në zonat me përqendrim të komunitetit. | Numri i objekteve në posedim të familjeve rome/egjiptiane të legalizuara ose të trajtuara me masa alternative (kompensim/strehim). | 0 | 500 raste të trajtuara (legalizim ose zgjidhje alternative) deri në 2030; raportim vjetor i detyrueshëm | | ASHK (Agjencia Shtetërore e Kadastrës) | MF, NJVV, OJF, struktura të asistencës ligjore | 2026-2030 |
| Miratimi dhe zbatimi i rregulloreve për trajtimin me strehim prioritar të familjeve, banesat e të cilave nuk mund të legalizohen për shkak të planeve urbanistike. | Përqindja e NJVV-ve që kanë plane 5-vjeçare strehimi aktive dhe të financuara nga Buxheti i Shtetit. | 61 NJVV (100% kanë aprovuar plan 5-vjeçar) | 100% e NJVV me plane aktive + të financuara (të paktën 70% me financim të kontraktuar çdo vit | | MEI | NJVV, EKB, MSHMS/SHSSH, donatorë/CoE/EU (kur ka), OJF | 2026-2030 |
| Trajnimi i stafit vendor mbi kriteret e | Numri i rasteve të zgjidhura përmes ndërmjetësimit të | 0 | 500 raste të zgjidhura deri në | | MEI | NJVV, EKB, ASHK, donatorë, OJF | 2026-2030 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| pikëzimit që favorizojnë grupet e margjinalizuara në programet sociale. | pagesave[4]për familjet në pamundësi ekonomike. | | 2030 (me raportim vjetor nga NJVV | | | | |
| Integrimi i programeve të strehimit me paketat e punësimit për të garantuar qëndrueshmërinë e pagesave të kredive ose qirave në afatgjatë. | | | | | MEIF | MEI | 2026-2030 |
| Përditësimi dhe konsolidimi periodik i bazës së të dhënave online të strehimit, në koordinim me bashkitë, duke integruar të dhënat mbi aplikimet për programet sociale dhe nevojat reale të familjeve për strehim. | | | | | MEI | INSTAT, ASHK, NJVV, MSHMS/SHSSH, OJF | 2026-2030 |
| Organizimi i fushatave informuese “derë më derë” mbi kriteret, procedurat dhe afatet e aplikimit për programet e strehimit social. | | | | | MEI | MSHMS/SHSSH, OJF rome/ egjiptiane, mediatorë, media lokale | 2026-2030 |

[4]Ndërmjetësimi i pagesave nënkupton procesin përmes të cilit një institucion, strukturë ose person i autorizuar lehtëson, administron ose garanton kryerjen e një pagese midis dy palëve.

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Organizimi i aktiviteteve informuese dhe këshilluese mbi procedurat e legalizimit të objekteve dhe dokumentacionin e nevojshëm, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për legalizimin. | | | | | MEI | NJVV/Agjencia Shtetërore e Kadastrës | 2026-2030 |

| **Fusha Prioritare III: Kujdesi Shëndetësor** | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qëllimi i Politikës III: Garantimi i mbrojtjes së shëndetit dhe aksesit universal në shërbime shëndetësore cilësore për pakicat rome dhe egjiptiane, duke eliminuar pabarazitë në treguesit e jetëgjatësisë dhe mirëqenies.** | | | | | | | |
| **Objektivi III.1: Sigurimi i shërbimeve shëndetësore parësore dhe parandaluese përmes afrimit të shërbimit tek qytetari dhe eliminimit të barrierave gjeografike e financiare.** | | | | | | | |
| **Masat dhe Aktivitetet Kryesore** | **Treguesit e Performancës** | **Baseline 2025** | **Target 2030** | **Rezultatet e Pritshme** | **Institucioni Përgjegjës** | **Institucionet Partnere** | **Afati Kohor** |
| Forcimi dhe institucionalizimi i shërbimeve të ekipeve mobile shëndetësore në zonat me përqendrim të romëve dhe egjiptianëve, duke garantuar mbulim territorial, frekuencë të rregullt vizitash dhe mekanizëm efektiv referimi. | % e popullsisë rome dhe egjiptiane të mbuluar me të paktën 1 vizitë nga ekipet mobile në vit.<br><br>Numri i vizitave të kryera nga ekipet mobile për 1,000 banorë romë/egjiptianë.<br><br>% e rasteve të referuara nga ekipet mobile që marrin shërbim brenda 14 ditëve. | 29,103 | 32,000 | Deri në vitin 2030, rritet ndjeshëm shkalla e mbulimit dhe përdorimit të shërbimeve shëndetësore bazë, diagnostikuese dhe parandaluese nga komunitetet rome dhe egjiptiane, duke reduktuar pabarazitë në shëndet. | MSHMS | OSHKSH, ISHP, NJVV, OJF, mediatorë | 2026-2030 |
| Rritja e mbulimit të kontrollit bazë mjekësor për grupmoshën 35-70 vjeç përmes mekanizmave aktivë të identifikimit dhe ndjekjes sistematike sipas gjinisë dhe grupmoshës. | % e personave 35-70 vjeç që kryejnë kontrollin mjekësor bazë sipas grupmoshave dhe gjinisë. | 5% rritje | 10% | | MSHMS | MSHMS, OSHKSH, ISHP | 2026-2030 |
| Realizimi i fushatave aktive të vaksinimit "derë më derë" për të | % e fëmijëve romë dhe egjiptianë të vaksinuar sipas kalendarit kombëtar (DTP3, Polio, MMR). | 90% | (95% të vaksinuar me vaksinat bazë të kalendarit kombëtar të vaksinimit) | | MSHMS, OSHKSH, ISHP | ISHP, OSHKSH | 2026-2030 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| rritur mbulimin me vaksina bazë sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit për fëmijët.<br><br>Zbatimi i një sistemi aktiv gjurmimi dhe rikujtimi për identifikimin dhe rikuperimin e fëmijëve me te vaksinuar vone sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit<br><br>Hartimi dhe monitorimi i planit vjetor të vizitave në terren dhe analizë të situatës. | % e fëmijëve romë dhe egjiptianë me vaksina të vonuara që rikuperohen brenda vitit.<br><br>% e vizitave të personelit mjekesor qe kryen vaksinimin në terren të realizuara sipas planit vjetor. | | | | | | |
| Organizimi i fushatave sensibilizuese mbi rëndësinë e vaksinimit në bashkëpunim me mediatorët e komunitetit dhe personelin shëndetësor, si dhe zbatimi i fushatave të vaksinimit" check-up" | Numri i rasteve me fruth dhe rubeolë tek romët dhe egjiptianët | 2 raste | 0 raste me fruth dhe rubeolë | | MSHMS, OSHKSH, ISHP | ISHP, OSHKSH | 2026-2030 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Zhvillimi dhe zbatimi i një programi të detyrueshëm trajnimi mbi mosdiskriminimin, antigjipsizmin dhe komunikimin ndërkulturor për stafin mjekësor dhe administrativ të QSH-ve në zonat me përqendrim të komuniteteve rome dhe egjiptiane.<br><br>Integrimi i protokolleve anti-diskriminim në manualet e cilësisë së QSH-ve<br><br>Vendosja e një mekanizmi të strukturuar raportimi dhe monitorimi të rasteve të diskriminimit në QSH. | % e stafit të QSH-ve në zonat me komunitete rome dhe egjiptiane të trajnuar për mosdiskriminimin.<br><br>% e QSH-ve që zbatojnë protokolle anti-diskriminim (në manualin e cilësisë).<br><br>Numri i rasteve të raportuara të diskriminimit për 1,000 vizita. | 120 punonjës mjekësor dhe administrativ të trajnuar | 250 punonjës mjekësor dhe administrativ të trajnuar | | MSHMS, ISHP | OSHKSH, ISHP, KMD | 2026-2030 |
| Identifikimi proaktiv i grave shtatzëna përmes rrjetit të infermierëve dhe mediatorëve për të garantuar kontrollin antenatal, post- | % e nënave rome dhe egjiptiane që përfitojnë paketën e plotë të kujdesit antenatal/postnatal.<br><br>% e nënave rome dhe egjiptiane me minimum 4 vizita antenatale. | 12,622 nëna rome dhe egjiptiane | 95% më shumë nëna rome dhe egjiptiane që përfitojnë nga kujdesi dhe vizitave antenatal/postnatal. | | MSHMS, NJVV | NJVKSH, ISHP, Donator | 2026-2030 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| natal të nënës dhe foshnjës. | % e foshnjave rome dhe egjiptiane të vizituara brenda 7 ditëve pas lindjes. | 0 | 95% e foshnjave rome dhe egjiptiane të vizituara brenda 7 ditëve pas lindjes. | | | | |
| Vendosja e mekanizmit për gratë shtatzëna rome dhe egjiptiane për garantimin e realizimit të të paktën katër vizitave antenatale. | | | | | MSHMS, NJVKSH | NJMF, NJVV, mediatorë, OJF | 2026-2030 |
| Miratimi dhe zbatimi i një protokolli të detyrueshëm referimi nga materniteti drejt Qendrës Shëndetësore për planifikimin dhe realizimin e vizitës së foshnjës brenda 7 ditëve nga lindja. | | | | | MSHMS, QSH | KMD, OJF, Avokati i Popullit | 2026-2030 |
| Rishikimi i kuadrit ligjor për Kujdesin Shëndetësor Parësor për të përmirësuar procedurat e regjistrimit të personave pa dokumente identiteti pranë mjekut të familjes. | | | | | MSHMS | MPB | 2026-2030 |
| Forcimi i mekanizmave të informimit, identifikimit dhe asistencës | Numri i bonuseve të lindjes për nënat nga komunitetet rome dhe egjiptiane | 1,010 familje | 1,300 familje | | MSHMS, SHSSH | ISHP, Donator, OJF | 2026-2030 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| administrative për përfitimin e bonusit të bebes nga nënat rome dhe egjiptiane, përmes bashkëpunimit ndërmjet strukturave të mbrojtjes sociale, shërbimit shëndetësor dhe mediatorëve. | | | | | | | |
| Krijimi i fushatave specifike mbi mënyrën e aksesimit të shërbimeve shëndetësore përmes sistemit të referimit dhe portalit e-Albania (me mbështetjen e mediatorëve). | Numri i fushatave ndërgjegjësuese të realizuara direkt në terren (në lagjet e banimit) dhe numri i pjesëmarrësve të arritur. | 0 | 30 fushata ndërgjegjësuese | | MSHMS | OSHKSH, NJVKSH, OJF, Donator | 2026-2030 |

| **Objektivi III.2: Krijimi, institucionalizimi dhe funksionalizimi i qëndrueshëm i sistemit të mediatorëve shëndetësorë nga komunitetet rome dhe egjiptiane.** | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitetet Kryesore** | **Treguesit e Performancës** | **Baseline 2025** | **Target 2030** | **Rezultatet e Pritshme Masat dhe** | **Institucioni Përgjegjës** | **Institucionet Partnere** | **Afati Kohor** |
| Përgatitja dhe miratimi i VKM-së për statusin, rolin, përshkrimin e punës dhe kategorizimin e pagës së mediatorit shëndetësor. | Pozicioni i mediatorit shëndetësor i miratuar zyrtarisht me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) dhe i përfshirë në strukturat organike të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. | VKM e miratua | Pozicion i konsoliduar (akt nënligjor/strukturë + buxhet i dedikuar) | Deri në vitin 2030, funksionon një rrjet kombëtar dhe i mirëfilltë mediatorësh shëndetësorë të integruar në stafin e qendrave shëndetësore, duke siguruar orientimin e komuniteteve dhe rritjen e përfaqësimit të tyre në sistemin mjekësor. | MSHMS | OSHKSH, , DAP, MF | 2026-2030 |
| Zgjerimi i rrjetit të mediatorëve shëndetësorë romë dhe egjiptianë përmes planifikimit të nevojave territoriale dhe financimit të pozicioneve të reja në zonat me përqendrim të lartë komunitar.<br><br>Standardizimi dhe certifikimi i detyrueshëm i mediatorëve përmes zhvillimit dhe zbatimit të një programi kombëtar trajnimi dhe akreditimi.<br><br>Formalizimi i statusit të mediatorëve përmes punësimit me kontrata të | Numër absolut + raport mediatorësh për 10,000 banorë romë/egjiptianë.<br><br>% e mediatorëve të certifikuar sipas standardeve kombëtare.<br><br>% e mediatorëve të punësuar me kontratë të rregullt.<br><br>% e mediatorëve të punësuar nga komuniteti romë dhe egjiptian. | 37 mediatorë romë dhe egjiptianë | 50% më shumë mediatorë romë dhe egjiptianë të certifikuar.<br><br>50% më shumë mediatorë romë dhe egjiptianë të punësuar.<br><br>50% më shumë mediatorë romë dhe egjiptianë të punësuar në komunitet. | | MSHMS | OSHKSH, OJF, qendra trajnimi | 2026-2030 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| rregullta dhe dhënia përparësi rekrutimit nga pakicat rome dhe egjiptiane. | | | | | | | |
| Identifikimi dhe promovimi aktiv i kandidatëve nga komunitetet rome dhe egjiptiane.<br><br>Vendosjen e kuotave ose pikëzimit preferencial në proceset e rekrutimit publik.<br><br>Monitorimin vjetor të rritjes së përqindjes së profesionistëve të punësuar nga këto komunitete. | % e rritjes vjetore të mjekëve / infermierëve të punësuar nga komunitetet vulnerabël. | 0 | 200 romë dhe egjiptianë të punësuar | | OSHKSH | OSHKSH, OJF, qendra trajnimi | 2026-2030 |
| Krijimi i një programi të dedikuar bursash dhe kuotash pranimi për studentët romë dhe egjiptianë në programet e studimit mjekësor dhe teknik shëndetësor. | Numri i studentëve romë dhe egjiptianë që përfitojnë bursa studimi dhe kuota të dedikuara në Fakultetin e Mjekësisë dhe Shkencave Mjekësore Teknike. | 0 | 50 student romë dhe egjiptianë që përfitojnë bursa studimi | | MA, Universiteti i Mjekësisë | OSHKSH, OJF, qendra trajnimi | 2026-2030 |
| Akordimi i bursave të plota dhe kuotave të | | | | | MA | Rektorate, Fakulteti i | 2026-2030 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| dedikuara për maturantët romë dhe egjiptianë që ndjekin studimet në mjekësi, infermieri dhe shëndet publik. | | | | | | Mjekësisë, donatorë/OJF | |
| Mentorimi dhe ndjekja e ecurisë akademike të studentëve përfitues për të parandaluar braktisjen e studimeve. | | | | | MA, MSHMS | Rektorate, Fakulteti i Mjekësisë, donatorë/OJF | 2026-2030 |
| **Objektivi III.3: Fuqizimi i informimit, edukimit dhe sensibilizimi në komunitetet rome dhe egjiptiane për rritjen e ndërgjegjësimit mbi mbrojtjen e shëndetit.** | | | | | | | |
| **Masat dhe Aktivitetet Kryesore** | **Treguesit e Performancës** | **Baseline 2025** | **Target 2030** | **Rezultatet e Pritshme** | **Institucioni Përgjegjës** | **Institucionet Partnere** | **Afati Kohor** |
| Prodhimi dhe shpërndarja e materialeve informuese në gjuhë të thjeshtuar dhe të përshtatura kulturalisht, përfshirë gjuhën rome. | Numri i materialeve të prodhuara dhe të shpërndara<br><br>% e materialeve të prodhuara në gjuhën rome / të thjeshtuar<br><br>% e familjeve që kanë parë materialet | 4 materiale të prodhuara | 10 materiale të prodhuara | Deri në vitin 2030, të rritet ndjeshëm niveli i njohurive mbi të drejtat shëndetësore dhe shërbimet e disponueshme, duke rezultuar në një rritje të kërkesës për shërbime parandaluese dhe kujdes shëndetësor maternal nga komunitetet. | MSHMS | ISHP, NJVKSH, OSHKSH, OJF, Media publike | 2026-2030 |
| Organizimi i sesioneve edukative të matshme me instrumente vlerësimi para dhe pas ndërhyrjes për rritjen e njohurive mbi vaksinimin dhe kujdesin ndaj foshnjave. | % e pjesëmarrësve që raportojnë rritje të njohurive mbi rëndësinë e vaksinimit dhe kujdesit ndaj foshnjave. | 0 | 2000 gra të intervistuara | | MSHMS | OSHKSH, ISHP, maternitetet, NJVV, OJF | 2026-2030 |
| **Objektivi III.4: Reduktimi i përhapjes së sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (SST) dhe përmirësimi i shëndetit riprodhues në komunitetet rome dhe egjiptiane.** | | | | | | | |

| Masat dhe Aktivitetet Kryesore | Treguesit e Performancës | Baseline 2025 | Target 2030 | Rezultatet e Pritshme | Institucioni Përgjegjës | Institucionet Partnere | Afati Kohor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Organizimi i fushatave sensibilizuese për SST, të shoqëruara me materiale edukative dhe vlerësim të rritjes së njohurive të pjesëmarrësve. | Numri i sesioneve edukative të realizuara në komunitet<br><br>% e pjesëmarrësve që raportojnë rritje të njohurive mbi SST<br><br>Numri i materialeve të prodhuara për SST | 5 fushata | 20 fushata | Deri në vitin 2030, të sigurohet mbulimi i plotë me informim, diagnostikim dhe trajtim falas për SST-të, duke rritur shkallën e zbulimit të hershëm dhe duke minimizuar pasojat afatgjata në shëndetin riprodhues të komunitetit. | MSHMS, ISHP | OSHKSH, OJF, mediatorë | 2026-2030 |
| Forcimi i mekanizmit të ndjekjes dhe mbështetjes së pacientëve të diagnostikuar për garantimin e përfundimit të trajtimit dhe aksesit efektiv në barnat e rimbursuara. | % e rasteve të diagnostikuara që përfundojnë trajtimin.<br><br>% e barnave të rimbursuara të marra me sukses nga pacientët. | 450 nga përfituesit gra përfitojnë medikamente/vizita | 700 përfitues | | MSHMS | ISHP, NJVKSH | 2026-2030 |
| Zgjerimi i aksesit në mjetet moderne kontraceptive përmes ofrimit falas në Kujdesin Shëndetësor Parësor, këshillimit të strukturuar mbi planifikimin familjar dhe fushatave informuese të targetuara për gratë 15-49 vjeç, me fokus në | Numri i kontraceptivëve të shpërndarë falas<br><br>% e grave 15-49 vjeç që përdorin mjete moderne kontraceptive.<br><br>% e përdoruesve të rinj të kontraceptivëve. | 0 | 5,000 njësi | | MSHMS | OSHKSH, ISHP, FSDKSH, | 2026-2030 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| përdoruesit për herë të parë. | | | | | | | |

| Fusha Prioritare IV. Arsimi dhe Nxitja e Dialogut Ndërkulturor | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qëllimi Politikës IV: Forcimi i barazisë së mundësive në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për romët dhe egjiptianët, nga arsimi parashkollor deri në arsimin e lartë, si dhe promovimi i dialogut ndërkulturor për romët dhe egjiptianët** | | | | | | | |
| **Objektivi IV.1 Sigurimi i aksesit, pjesëmarrjes dhe përfundimit të arsimit nga nxënësit dhe studentët romë dhe egjiptianë përmes masave mbështetëse financiare, sociale dhe institucionale.** | | | | | | | |
| **Masat dhe Aktivitetet Kryesore** | **Treguesit e Performancës** | **Baseline** | **Target** | **Rezultatet e Pritshme** | **Institucioni Përgjegjës** | **Institucionet Partnere** | **Afati Kohor** |
| Përjashtimi ose reduktimi i tarifave në institucionet arsimore parashkollore, për fëmijët romë dhe egjiptianë. | Numri i bashkive që zbatojnë politika për reduktim ose përjashtim tarifash. | 10 | 30 | Deri në vitin 2030, të rritet pjesëmarrja dhe përfundimi i arsimit nga fëmijët dhe nxënësit romë dhe egjiptianë nëpërmjet mbështetjes arsimore. | MA, NJVV | DRAP/ZVAP; OJF; Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve | 2026-2030 |
| Identifikimi dhe regjistrimi në kohë i fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsimin parashkollor dhe bazë. | Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë të regjistruar në arsimin parashkollor. | 2485 | 2857 | | MA | NJVV; DRAP/ZVAP; DAP; Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve; OJF | 2026-2030 |
| Sigurimi i transportit falas për nxënësit që banojnë larg institucioneve arsimore. | Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që përfitojnë transport falas. | 979 | 1125 | | MA | AKAP DRAP/ZVAP; IAL; OJF; komuniteti | 2026-2030 |
| Zbatimi i programeve mbështetëse pas mësimit nëpërmjet shkollave si qendër komunitare për arsimin bazë. | Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që ndjekin arsimin bazë me kohë të plotë. | 14300 | 16445 | | MA | Shkollat qendër komunitare; NJVV; DRAP/ZVAP; OJF | 2026-2030 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Zbatimi i programit të arsimit bazë me kohë të pjesshme për nxënësit jashtë sistemit arsimor | Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që përfundojnë arsimin bazë, përmes programeve me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. | 3776 | 4342 | | MA | DRAP/ZVAP; NJVV; Shërbimet sociale; OJF | 2026-2030 |
| | Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë përfitues nga programet mbështetëse arsimore (programe pas mësimit dhe mësim i gjuhës rome). | 975 | 1121 | | MA | DRAP/ZVAP; NJVV; Qendrat komunitare; OJF | 2026-2030 |
| Angazhimi dhe trajnimi i mediatorëve për ndërmjetësimin ndërmjet shkollës, familjes dhe komunitetit. | Numri i nxënësve të mbështetur nga ndërmjetësimi i mediatorëve. | Nuk ka të dhëna (2025) | Rritje ≥ 50% dhe raportim vjetor | Deri në vitin 2030, të rritet frekuentimi dhe vazhdimësia në arsim për nxënësit dhe studentët romë dhe egjiptianë përmes mbështetjes sociale. | MA / NJVV | DRAP/ZVAP; DAP; operatorët e transportit; OJF | 2026-2030 |
| Rritja e subvencionimit shtesë në skemën e ndihmës ekonomike për familjet me fëmijë në shkollë. | Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë përfitues nga subvencionimi i ndihmës ekonomike. | 1,314 | 1,577 | Deri në vitin 2030, të rritet numri i nxënësve dhe studentëve romë dhe egjiptianë përfitues nga skemat financiare mbështetëse në të gjitha nivelet e arsimit. | NJVV | MSHMS MA; DRAP/ZVAP; këshillat bashkiakë | 2026-2030 |
| Zgjerimi dhe rishikimi i skemave të bursave për nxënësit në arsimin e mesëm, por edhe në arsimin e detyrueshëm bazë. | Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë përfitues nga bursat në arsimin e mesëm. | 731 | 840 | | NJVV | MA; MSHMS; shkollat; OJF | 2026-2030 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Ofrimi i bursave dhe përjashtimi ose reduktimi i tarifave për studentët në arsimin e lartë. | Numri i studentëve romë dhe egjiptianë përfitues nga bursa, përjashtim ose reduktim tarifash. | Nuk ka të dhëna (2025) | Rritje e qëndrueshme dhe raportim vjetor | | MA | NJVV; Institucionet e Arsimit të Lartë; OJF | 2026-2030 |
| **Objektivi IV.2: Krijimi i një sistemi arsimor të barabartë, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt cilësisë, që mundëson pjesëmarrjen e plotë të romëve dhe egjiptianëve në të gjitha nivelet e arsimit.** | | | | | | | |
| **Masat dhe Aktivitetet Kryesore** | **Treguesit e Performancës** | **Baseline** | **Target** | **Rezultatet e Pritshme** | **Institucioni Përgjegjës** | **Institucionet Partnere** | **Afati Kohor** |
| Trajnimi dhe kualifikimi i mësuesve, psikologëve dhe punonjësve socialë për arsimin gjithëpërfshirës, diversitetin dhe antigjipsizmin. | Përqindja e personelit arsimor të trajnuar për arsimin gjithëpërfshirës, diversitetin dhe antigjipsizmin. | 65% | 100% | Deri në vitin 2030, të përmirësohet cilësia dhe gjithëpërfshirja e arsimit për romët dhe egjiptianët përmes zhvillimit të kompetencave të stafit arsimor dhe rishikimit të kurrikulave. | MA | ASCAP; institucionet e trajnimit; DRAP/ZVAP; OJF; KMD | 2026-2030 |
| Analizimi dhe rishikimi i kurrikulave dhe teksteve shkollore për eliminimin e stereotipave dhe përfshirjen e historisë dhe kulturës rome dhe egjiptiane. Trajnimi i mësuesve për zbatimin e kurrikulave të rishikuara. | Përqindja e kurrikulave dhe teksteve të rishikuara për përfshirjen e historisë dhe kulturës rome dhe egjiptiane. | 25% | 100% | | MA | ASCAP; akademikë; OJF; partnerë ndërkombëtarë | 2026-2030 |
| Zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulës së gjuhës rome në arsimin | Numri i institucioneve arsimore që ofrojnë mësimin e gjuhës rome. | 2 | 15% | | MA | ASCAP; DRAP/ZVAP; IAL; OJF; komuniteti | 2026-2030 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| parauniversitar dhe universitar. | | | | | | | |
| Parandalimi i shkollave të segreguara. | Numri i shkollave dhe klasave të segreguara. | 0 | 0 | Deri në vitin 2030, të eliminohen klasat dhe shkollat e segreguara dhe të reduktohet ndjeshëm braktisja shkollore e nxënësve romë dhe egjiptianë. | MA | AKAP DRAP/ZVAP; NJVV; KMD; OJF | 2026-2030 |
| Identifikimi i nxënësve jashtë sistemit arsimor ose në rrezik braktisjeje dhe funksionalizimi i grupeve ndërsektoriale në nivel vendor. | Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që braktisin arsimin e detyrueshëm. | Nuk ka të dhëna (2025) | Ulja vjetore dhe raportim i detyrueshëm | | MA, NJVV | Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve; MSHMS; shkollat; OJF | 2026-2030 |
| Referimi i familjeve në shërbimet e mbrojtjes sociale dhe skemat mbështetëse për përfundimin e arsimit bazë. | Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë të rikthyer në shkollë përmes mekanizmave ndërsektorial. | 103 (2025) | 206 Rritje vjetore dhe raportim i detyrueshëm | | MA, NJVV | MSHMS; SHSSH; Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve; OJF | 2026-2030 |

| **Objektivi IV.3: Rritja e numrit të programeve, projekteve dhe aktiviteteve publike që promovojnë kulturën rome dhe egjiptiane, si dhe përfaqësimi i romëve dhe egjiptianëve në institucionet publike të kulturës.** | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Masat dhe Aktivitetet Kryesore** | **Treguesit e Performancës** | **Baseline** | **Target** | **Rezultatet e Pritshme** | **Institucioni Përgjegjës** | **Institucionet Partnere** | **Afati Kohor** |
| Organizimi i festivaleve, panaireve, ekspozitave dhe eventeve përkujtimore në nivel kombëtar dhe vendor. | Numri i aktiviteteve kulturore dhe artistike që promovojnë kulturën rome dhe egjiptiane. | ≥ 10 (2025) | ≥ 20 (2030) | Deri në vitin 2030, të rritet ndjeshëm prania e kulturës rome dhe egjiptiane në programet publike kulturore dhe në institucionet e kulturës, krahasuar me vitin 2025. | MTKS,<br>NJVV | RTSH;<br>institucionet kulturore;<br>OJF;<br>partnerë | 2026-2030 |
| Përfshirja e aktiviteteve për kulturën rome dhe egjiptiane në kalendarët kulturorë të institucioneve publike.<br>Realizimi i programeve mediatike dhe dokumentarëve në mediat publike. | Numri i projekteve të financuara për organizatat rome dhe egjiptiane. | 8 | 16 | | MTKS,<br>Komiteti për Pakicat Kombëtare | NJVV;<br>donatorë;<br>OJF | 2026-2030 |
| Përcaktimi i fondeve të dedikuara për projektet kulturore të romëve dhe egjiptianëve. | Numri i botimeve dhe materialeve kulturore në gjuhët e pakicave. | 5 | 10 | | MTKS | QKLL;<br>BK;<br>IAL;<br>OJF | 2026-2030 |
| Mbështetja e botimeve dhe materialeve kulturore në gjuhët e pakicave. | Numri i romëve dhe egjiptianëve të punësuar në institucionet publike të kulturës. | Nuk ka të dhëna (2025) | Rritje e qëndrueshme dhe raportim vjetor | | MTKS,<br>DAP | Institucionet kulturore publike;<br>NJVV;<br>OJF | 2026-2030 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Përfshirja e profesionistëve romë dhe egjiptianë në projektet dhe programet kulturore publike. | | | | | MTKS,<br>Komiteti për Pakicat Kombëtare | NJVV;<br>donatorë;<br>OJF | 2026-2030 |
| Nxitja e punësimit të profesionistëve romë dhe egjiptianë në institucionet e kulturës. | | | | | MTKS,<br>NJVV | RTSH;<br>institucionet kulturore;<br>OJF;<br>partnerë | 2026-2030 |

| Fusha Prioritare V: Punësimi dhe Aftësimi | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qëllimi Politik: Garantimi i aksesit të barabartë në tregun e punës dhe fuqizimi ekonomik i pakicave rome dhe egjiptiane përmes punësimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.** | | | | | | | |
| **Objektivi V.1: Rritja e pjesëmarrjes së romëve dhe egjiptianëve në formimin profesional dhe programet e nxitjes së punësimit, me synim punësimin e qëndrueshëm.** | | | | | | | |
| **Masat dhe Aktivitetet Kryesore** | **Treguesit e Performancës** | **Baseline** | **Target** | **Rezultatet e Pritshme** | **Institucioni Përgjegjës** | **Institucionet Partnere** | **Afati Kohor** |
